



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 15/2019 (JR)
Datë 06.03.2019

Vendim nr. 6 (JR)
Datë 18.06.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.06.2020, ditën e enjte, në orën 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia Roessingh-Bakels, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Alltun Çela, gjyqtar, me detyrë kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 95, datë 08.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 dhe neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 95, datë 08.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Alltun Çela, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqarit dhe njëkohësisht edhe të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës.
2. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”). Konkretisht:

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se:

- i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të figurës, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, bazuar në parime dhe në kushtet e parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e rishikuar me konstatimin për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e ushtrimit të detyrës².

2.3. KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³.

3. Procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit është kryer për të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Me vendimin nr. 95, datë 08.01.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Konkluzionet e Komisionit për secilin kriter vlerësimi shtjellohen në vijim.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk ka arritur të sqarojë bindshëm apo të paraqesë prova për të shpjeguar mospërputhjen mes sipërfaqes së pronës prej 500 m² të përfituar me AMTP [shtëpi dhe truall] dhe sipërfaqes prej 600 m² të përfituar prej tij sipas vërtetimit të Njësisë Administrative {***} të datës 13.10.2016;

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 08.01.2018.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 24.07.2018.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 19.04.2018.

- ii. mbeti e paqartë se si kjo pronë që sipas AMTP-së përbëhej nga 500 m², me vendim gjykate u regjistrua me sipërfaqe 600 m²;
- iii. ka kryer deklaram të rremë përpara Komisionit për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga babai i tij si trashëgimi, që bie ndesh me vendimin nr. {***}, datë 12.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë, i cili i ka njohur subjektit pronësinë;
- iv. nuk bindi Komisionin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë, kryetar i së cilës ishte subjekti në kohën e shqyrtimit të çështjes, ishte e vetmja gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës së babait të subjektit për njohjen e pronësisë mbi shtëpinë në fshatin {***}, dhe se nuk kishte asnjë mënyrë për të shmangur konfliktin e interesit midis gjyqtarëve të çështjes dhe atij vetë si kryetar i kësaj gjykate;
- v. ka bërë deklaram të rremë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me sipërfaqen e apartamentit në pronësi tek {***} në deklaratat periodike të pasurisë, si dhe atë “vetting”;
- vi. ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke zgjeruar sipërfaqen e banimit të tij përtej lejes së ndërtimit të dhënë nga organi kompetent në pasurinë e mësipërme;
- vii. ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit në disa raste;
- viii. ka kryer fshehje të pasurisë prej 61,1 m²;
- ix. ka kryer deklaram të rremë për sipërfaqen e truallit prej 400 m², duke e deklaruar si pasuri të tijën, në mungesë të dokumentacionit provues të pronësisë;
- x. me cilësinë e kryetarit të gjykatës, nuk ka marrë asnjë masë për pasqyrimin me vërtetësi dhe transparencë të të dhënave të çështjeve gjyqësore në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit *është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.*

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit *ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim nën nivelin mesatar dhe nuk është efektiv.* Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe ka mangësi të theksuara në arsyetimin ligjor, në parashtrimin e fakteve dhe përdorimin e doktrinës juridike.

- 5.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit:
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;
 - rezultoi i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës;
 - ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe mungesë efikasiteti, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës për një vit nuk mund ta zgjidhë këtë çështje; dhe
 - në vlerësim tërësor të të tria kriterëve të rivlerësimit, me veprimet/mosveprimet e tij ka cenuar rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

III. Shkaqet e ankimit

- 6.** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit që vendosi sa më sipër⁴. Ankimi, i cili u pranua nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 21.02.2019, bazohet në nenin 179/b, pika 5, në nenin F i Aneksit të Kushtetutës, në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”), në nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).

⁴ Ankimi është regjistruar në Komision me nr. {***}prot., datë 20.02.2019.

7. Shkaqet e ankimit lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, pretendime për shkelje procedurale, pretendime që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe me vlerësimin që ka kryer Komisioni për secilin kriter të procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
8. Shkaqet e ankimit që lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkelje procedurale dhe procesin e rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur janë si vijojnë.
- i) Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 45, 51, 52 e 61 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në dyshime, siç rezulton nga përdorimi gjatë gjithë arsyetimit i shprehjeve: “[...] subjekti nuk ka arritur të japë sqarim bindës [...]” ose “dyshohet se”, “mendohet se”, “mund”, “duket sikur”.
 - ii) Komisioni nuk citon në asnjë rast se cilat janë provat që ka administruar të cilat nuk e kanë bindur nga tërësia e provave të paraqitura nga subjekti, dhe që e kanë vënë subjektin dhe publikun në pamundësinë e kontrollit efektiv të kësaj vendimmarrjeje.
 - iii) Vendimmarrja e Komisionit është e njëanshme, e pabazuar në provat e paraqitura prej tij dhe në gjetjet e analizës financiare. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimmarrja e Komisionit nuk bazohet respektivisht në dispozitat mbështetëse si vijojnë: në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 17, 30, 31, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016; në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 40, 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016.
 - iv) Vendimi përmban “shenja armiqësore” të denigrimit të figurës dhe familjes kur përdor terma të tillë, si: “babai pasi doli nga burgu”, ndërkohë që i ati [i subjektit të rivlerësimit] ka qenë i dënuar politik.
 - v) Komisioni ka dalë nga misioni dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur standard të dyfishtë në raste të ngjashme dhe duke e vendosur subjektin në pozita diskriminuuese.
 - vi) Vendimi i Komisionit ka shkelur nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 duke qenë i paarsyetuar, alogjik, i parregullt në formë dhe i paqartë në përmbajtje (subjekti referon vendimin nr. 28/2014 të Gjykatës Kushtetuese).
 - vii) Vendimi i Komisionit është në kundërshtim me parashikimet e neneve 1, 2, 3, 16 pika 12, 27, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 41 pikat 3 dhe 4, 41 pika 1, 43, 44, 49 pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, 52 e 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe me ligjin nr. 96/2016. Komisioni i ka atribuar vetes kompetenca që u përkasin organeve të tjera, dhe që ligji ia njeh Komisionit vetëm kur gjatë hetimit arrin të evidentojë fakte të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit.
 - viii) Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka identifikuar personin anonim të denoncimi i të cilit ka bazuar të gjitha pyetjet në relacionin përfundimtar, për të tria kriteret.
 - ix) Arsyetimi i vendimit të Komisionit është në kundërshtim me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi: a) nuk janë paraqitur mbi 90% e provave, duke e vendosur subjektin në kushtet e pabarazisë së armëve në gjykim e, për pasojë, në arritjen e konkluzioneve të pambështetura në provat e dosjes; b) nuk është përcaktuar dispozita ligjore dhe shkelja konkrete ligjore ku mbështetet për çdo pikë të ngritur për shkarkim nga detyra; c) argumentet nuk janë në unitet dhe të lidhura ngushtë ndërmjet tyre. Ato janë të

pabazuara në fakte ose në prova të reja, veç atyre të depozituara nga subjekti dhe nga organet e tjera, ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja; vendimi është “nul”⁵, i paarsyetuar “me prova dhe në ligj”, pasi nuk përmban provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat mbështetet, duke mos qenë në përputhje me standardin strukturor që parashikon neni 310, paragrafi II, pika 2⁶ e Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”).

- x) Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 13 e 14 të KEDNj-së dhe me nenin 1 të Protokollit 12 (shtesë), duke cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat e subjektit pasi nuk ka kryer analizë të dispozitave ligjore procedurale dhe materiale, ka marrë një vendim haptazi të paarsyetuar, jo koherent dhe me mungesë përfundimesh logjike.
- xi) Komisioni, në vendimin e datës 08.01.2019, nuk ruan renditjen e çështjeve sipas relacionit mbi rezultatet e hetimit administrativ të datës 04.12.2018, duke krijuar shpesh mbivendosje, ngatërrësë dhe përzjerje të përgjigjeve dhe pyetjeve me rezultatet dhe konkludimin në përfundime jologjike me përgjigjet e dhëna pas kalimit të barrës së provës.
- xii) Komisioni është paragjykues dhe dukshëm i njëanshëm në “Relacionin mbi rezultatet e hetimit” të datës 04.12.2018 dhe në leximin e relacionit përpara publikut dhe medias në seancën e datës 04.01.2019. Kjo qasje e Komisionit është përkthyer në media si një lajm shkarkimi, ndërkohë që vendimi prej Komisionit do të merrej në datën 08.01.2019, duke e vendosur atë në kushtet e paragjykitimit dhe shprehjes së mendimit mbi çështjen.
- xiii) Komisioni nuk është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke cenuar rëndë garancitë e procesit të rregullt ligjor, të konfirmuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016.

9. Shkaqet e ankimit që lidhen me themelin e gjykimit për secilin kriter të rivlerësimit përmbledhen si vijojnë, sipas kriterëve.

9.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vendimit duke disponuar që deklarimi i tij është i saktë, në përputhje me ligjin, i bazuar në burime të ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

9.2. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vlerësimit të DSIK-së dhe të Komisionit, duke vendosur përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

9.3. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi është në kundërshtim me vlerësimin profesional të KLD-së, me provat e paraqitura prej tij dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe kërkon ndryshimin e vlerësimit sipas neneve 44 dhe 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi plotëson kriterin se ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke e vlerësuar të aftë për të vazhduar detyrën.

9.4. Lidhur me cenimin e besimit të publikut te drejtësia, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk qëndron përfundimi i Komisionit pasi nuk ka asnjë rrethanë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 që mund të shërbejë si shkak për shkarkimin nga detyra.

⁵ *Shih faqen 6 të ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit.*

⁶ *K.Pr.Civile në nenin 310, paragrafi II, pika 2 parashikon: “Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese arsyetuese dhe pjesën urdhëruese [...]. II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: [...] 2. provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi [...]”.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

10. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 95, datë 08.01.2019, u mor në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi në bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.
11. Nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”) vuri re se nuk gjente zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, që do të krijonte nevojën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve apo të krijonte nevojën e debatit gjyqësor, pasi nuk nevojitej vërtetimi i fakteve apo marrja e provave të reja, nuk u konstatuan shkelje procedurale dhe nuk nevojitej përsëritja e disa ose e të gjitha provave të marra nga Komisioni⁷. Nga materialet e administruara nga Komisioni, rezultuan të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspektet procedurale të vendimmarrjes

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 45, 51, 52 e 61 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në dyshime dhe duke mbështetur arsyetimin në shprehje, si: “Pasi shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të japë sqarim bindës” ose “dyshohet se”, “mendohet se”, “mund”, “duket sikur”. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim është artikuluar disa herë përgjatë ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe lidhet kryesisht me pretendimin se Komisioni nuk i ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij duke mos i pasqyruar, nuk është shprehur për to në vendim dhe, për pasojë, ka kryer shkelje të detyrimeve për një proces të rregullt ligjor në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 dhe KEDNj-në, si dhe në shkelje të parimeve të barazisë së armëve, kontradiktoritetit, objektivitetit dhe proporcionalitetit. Këtë shkelje, subjekti i rivlerësimit e pretendon në të tria kriteret e rivlerësimit.

12.1. Nga aktet e administruara nga Komisioni, analizuar në këndvështrim kronologjik për lehtësi reference dhe leximi, rezultojnë të ndërmarrë hapat:

- i) më datë 24.01.2018 ka filluar hetimi administrativ për kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit;
- ii) më datë 02.02.2018, subjekti të rivlerësimit i është përcjellë pyetësori i parë tip⁸;
- iii) më datë 04.12.2018, ka përfunduar hetimi administrativ;
- iv) më datë 06.12.2018, subjekti i rivlerësimit është njoftuar mbi përfundimin e kësaj faze të procesit, i është kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit dhe është njoftuar mbi të drejtën e mbrojtjes për të paraqitur prova, për të thirrur dëshmitarë, për t’u njohur me dosjen, si dhe për të paraqitur shpjegime;

⁷ Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon: “[...] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsëritet marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

⁸ Kthyer përgjigje nga subjekti më datë 05.02.2018, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 09.02.2018.

v) më datë 11.12.2018, subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën për njohjen me aktet e dosjes;

vi) më datë 24.12.2018 (18 ditë pas njoftimit të rezultateve të hetimit), subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit (226 dokumente sipas deklarimeve të tij në ankim);

vi) më datë 27.12.2018, subjekti i rivlerësimit është ftuar në seancë dëgjimore;

vii) më datë 04.01.2019, është zhvilluar seanca dëgjimore publike. Sipas procesverbalit, gjatë seancës publike subjekti i rivlerësimit është njohur sërish me konkluzionet e hetimit për secilën çështje, ka dhënë shpjegime dhe ka diskutuar me anëtarët e trupit gjykues të Komisionit dhe me vëzhguesen ndërkombëtare të ONM-së për sa u përket disa çështjeve të prezantuara prej tij, dhe ka parashtruar kërkesën për marrjen e provave të reja⁹, të cilat në përfundim të seancës dëgjimore u administruan nga Komisioni. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit është shprehur dakord me të gjitha gjetjet, të cilat sipas tij kanë qenë korrekte dhe të bazuara.

12.2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, rezulton se vendimi i Komisionit është mbështetur në analizën e raporteve të institucioneve të pavarura ndihmëse, si: ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja, provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit edhe sqarime shtesë për saktësi¹⁰, të vijuar edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka shqyrtuar dhe analizuar provat dhe shpjegimet e tij, nuk rezulton i bazuar në fakte. Nga përmbajtja e vendimit, nuk rezulton që Komisioni të jetë shprehur për refuzim të provave dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, duke i dhënë në këtë mënyrë të gjitha mundësitë dhe garancitë për t'u mbrojtur. Përmbajtja e shpjegimeve dhe provave të sjella nga subjekti është vlerësuar në harmoni me aktet e përcjella nga institucionet e përfshira në proces. Edhe gjatë seancës dëgjimore, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, u depozituan në cilësinë e provës dokumente të tjera në mbështetje të kundërshtimeve të tij ndaj gjetjeve të raportit të DSIK-së. Së fundmi, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore të ketë shprehur pretendime apo kërkesa që lidhen me cenimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor apo shkeljen e parimeve të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve.

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk citon provat që ka administruar nga tërësia e provave të paraqitura nga subjekti, të cilat nuk e kanë bindur. Në këtë mënyrë, subjekti dhe publiku është në pamundësi të kontrollit efektiv të kësaj vendimmarrjeje. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka argumentuar veprimet e kryera dhe rezultatet e hetimit administrativ, ka kryer vlerësimin e provave dhe të shpjegimeve të subjektit, ka analizuar e kryer interpretimin e tyre, si dhe ka dhënë konkluzionet për secilën çështje. Nga shqyrtimi i vendimit në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe me aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se dokumentacioni mbështetës i sjellë nga subjekti i rivlerësimit dhe shpjegimet e tij janë marrë në konsideratë, duke passjellë një interpretim të ndryshëm nga ai që duhet të ketë pritur subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se rezultati përfundimtar i Komisionit nuk është diktuar nga moskonsiderimi i provave, por nga interpretimi dhe vlerësimi i tyre në raport me kërkesat ligjore.

⁹ Vendimin e datës 13.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kërkesën për saktësim të objektit të padisë nga Avokatura e Shtetit; vërtetimin e datës 31.12.2018 të kancelarit të gjykatës lidhur me faktin se ndaj pronave të H.C nuk është ngritur kërkesëpadi në gjykatë nga Këshilli i Ministrave – prova këto për të vërtetuar faktin se nuk ka disponuar me vendim për pronat në {***}.

¹⁰ Sqarimet shtesë të datës 08.11.2018.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimmarrja e Komisionit është e njëanshme dhe e pabazuar në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016 për secilin prej kriterëve respektivisht (shih paragrafin 8, nënpika “iii” më sipër). Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nuk rezultojnë që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt të mundshëm interesi me anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, të ketë kërkuar përjashtimin e ndonjë anëtari, apo që ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues të ketë kërkuar heqje dorë, gjë e cila mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision. Anëtarët e trupit gjykues kanë plotësuar deklaratat për mungesë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon detyrimin e institucioneve të rivlerësimit për të ushtruar funksionet e tyre në kushtet e paanësisë në kuadër të parimeve që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor¹¹.
15. Pretendimet që lidhen me vlerësimin e kriterëve individualisht janë trajtuar gjerësisht në pjesën e këtij arsytimi që shtjellon pretendimet lidhur me themelin e çështjes për të tria kriteret dhe me disponimin ligjor për aplikimin e masës disiplinore. Siç shtjellohet më poshtë, në arsyetimin mbi kriteret e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se vendimmarrja e Komisionit është e drejtë dhe duhet të lihet në fuqi. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka shkelur etikën gjyqësore, siç përcaktohet në nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe me veprimet e mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit thekson se fakti që disa prej konkluzioneve të Komisionit, për sa i përket themelit të çështjes, janë rishikuar nga Kolegji, nuk nënkupton që Komisioni ka qenë i njëanshëm.
16. Pretendimi [i përsëritur] i subjektit të rivlerësimit për qëndrim paragjykes dhe “armiçësor” në vendimin e Komisionit që, sipas tij, përbën denigrim të figurës dhe familjes, ilustruar me terma të tilla si “babai pasi doli nga burgu”, që rezultojnë të jetë ngritur kryesisht në lidhje me secilin prej kriterëve të rivlerësimit, është i pabazuar. Nga dokumentet në fashikull, përfshirë procesverbalin e seancës, korrespondencën mes Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit, dhe arsyetimin e vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni nuk rezultojnë ta ketë vënë subjektin në situata denigruese, paragjyqëse dhe të ketë qenë armiçësor/antagonist. Togfjalëshi i përdorur nga Komisioni, “babai pasi doli nga burgu”, është marrë nga vendimi i datës 12.10.1995 i Gjykatës së Rrethit Delvinë, nga ku është shkëputur e gjithë fjalia vijuese: “[...] *Paditësi K.Ç shtëpinë në fjalë e ka ndërtuar konform rregullave, me leje të organeve shtetërore të asaj kohe, pas daljes nga burgu, mbasi para burgosjes së tij nuk ka pasur shtëpi [...]*”¹². Konteksti i përdorur nga Komisioni lidhet me faktin që shtëpia e banimit në {***} është ndërtuar me leje nga institucionet përgjegjëse të kohës, dhe jo e përfituar nga trashëgimia “ndër breza”, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit në pretendimet e tij nuk shpjegon se çfarë e motivon këtë lloj sjelljeje të Komisionit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbetet i paprovuar.
17. Sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi shprehjen e përdorur nga Komisioni mbi “*probleme të shumta*”¹³ në kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit

¹¹ Neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 5. Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor [...]”

¹² Shih faqen 13 të vendimit.

¹³ Në vendim, Komisioni shprehet se: “Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata “vetting”), të dorëzuara në ILDKPKI,

vlerëson se kjo shprehje nuk mund të përbëjë paragjykim të mënyrës së trajtimit të çështjeve që shqyrtohen gjatë procesit. Është diskrecion dhe përgjegjësi e institucioneve të rivlerësimit që çështjeve me rëndësi për procesin t'u japin një peshë më specifike për trajtim. Po kështu, edhe sa i përket pretendimit se mënyra e shprehjes nga Komisioni për referimin e gabuar në kohë të legjislacionit procedural civil provon paragjykim¹⁴, është i pabazë. Rezulton se Komisioni u referohet deklarimeve të subjektit, i cili në parashtrimet mbi rezultatet e hetimit administrativ ka trajtuar çështjen e shqyrtimit të padisë në vitin 1995 nga Gjykata e Rrethit Delvinë, mbështetur në nenet 41 dhe 45 të Kodit të Procedurës Civile, të miratuar më datë 29.03.1996¹⁵. Si rrjedhojë, edhe parë në këtë këndvështrim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi mungesë paanësie nga ana e Komisionit, mbështetur në fraza të vendimit që në fakt rezultojnë të jenë citime të shpjegimeve të tij, mbeti i paprovuar.

18. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka dalë nga misioni dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur standard të dyfishtë në raste të ngjashme dhe duke e vendosur subjektin në pozita diskriminuese. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se neni 18 i Kushtetutës parashikon barazinë e individëve përpara ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë etnike, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive¹⁶. Nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 parashikojnë qëllimin dhe objektin e ligjit. Zbatimi në praktikë i dispozitave të mësipërme nënkupton që vlerësimi i ndryshëm i situatave të njëjta, për subjekte të ndryshme, duhet të jetë i mirarsyetuar dhe i mirëbazuar, për të shmangur perceptimin e paragjyqimeve për një subjekt rivlerësimi. Në rastin konkret, nga analiza e akteve në fashikull, rezulton që për secilën çështje, Komisioni ka analizuar faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit, që janë administruar në gjykim, dhe ka argumentuar qëndrimin e mbajtur në përfundim të vlerësimit. Nga ana tjetër, përkundër pretendimit për diskriminim, subjekti i rivlerësimit nuk identifikon se mbi çfarë cilësie të përhershme, të mbrojtur nga neni 18 i Kushtetutës, është diskriminuar, cilat kanë qenë veprimet e Komisionit që kanë përbërë diskriminim dhe cilat janë veprimet nëpërmjet të cilave Komisioni ka dalë përtej misionit të tij. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë parashtruar në asnjë fazë të hetimit apo të procesit në Komision pretendime për veprime të këtij të fundit që përbëjnë trajtim të pabarabartë apo diskriminim të ndonjë natyre, përfshirë për ndonjërin nga cilësitë e mbrojtura nga neni 18 i Kushtetutës. I njëjti konstatim vlen edhe për mungesë indicieje apo pretendim të ngritur nga subjekti në ndonjë fazë të hetimit, sipas të cilit procesi i rivlerësimit nuk është kryer nga Komisioni në përputhje me tagrat e dhëna nga ligji nr. 84/2016. Edhe pretendimi i artikuluar në parashtrimet e ankimit që lidhen me pasaktësitë në deklarime, të konfliktit të interesit në vlerësimin e pasurisë dhe për vlerësimin e raportit të DSIK-së, për zbatim standardesh të ndryshme për subjekte të ndryshme nga Komisioni, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në pozita diskriminuese, mbetet i pabazuar. Ky konstatim është në përputhje edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, ku

verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje, si edhe të dhënave të përfituara dhe verifikimeve të bëra gjatë hetimit administrativ, u konstatuan probleme të shumta, por Komisioni vendosi të përqendrojë hetimin dhe rezultatet e tij mbi çështjet si më poshtë [...].

¹⁴ Shih faqen 22 të ankimit të subjektit të rivlerësimit që i referohet vendimit të Komisionit në faqen 13, paragrafi i dytë i nënparagrafit iv): “[...] subjekti, megjithëse ushtron funksionin e gjyqtarit pa ndërprerje, [...], për të arsyetuar marrëdhëniet juridike të ndodhura në vitin 1995, i referohet legjislacionit të vitit 1996 [...], si dhe arsyeton konfliktin e mundshëm të interesit në vitin 1995 me një ligj që ka hyrë në fuqi në vitin 1996 [...]”.

¹⁵ Neni 621 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Ky Kod hyn në fuqi më datë 01.06.1996.”

¹⁶ Mbi parimet që mbrojnë individët nga diskriminimi shih nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 14 të KEDNj-së në:

<https://www.parlament.al/Kuvendi/Kushtetuta> dhe https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SOI.pdf.

në çështjen *Uçar kundër Turqisë* ka arsyetuar se “nuk mund të flitet për “divergjenca” kur rrethanat e faktit në fjalë janë objektivisht të ndryshme”¹⁷. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit, me fokus juridiksionin interpretues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudentës¹⁸.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkelur nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 pasi sipas tij, vendimi nuk përmban elemente dhe cilësi themelore të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese¹⁹. Më konkretisht, sipas subjektit, vendimit të Komisionit i mungon arsyetimi dhe logjika, nuk është i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Neni 57 i ligjit nr. 84/2016 shtjellon me hollësi elementet përbërëse që duhet të ketë vendimi i Komisionit dhe i ndan ato në tri pjesë: hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese²⁰. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se analiza e të dyja këtyre burimeve kundrejt strukturës dhe përmbajtjes së vendimit të Komisionit tregon që ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, siç shtjellohet më poshtë, është i papabuar. Vendimi i Komisionit është në përputhje me kërkesat normative të ligjit.

19.1. Nga analiza e vendimit të Komisionit kundrejt përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 894/2106 konstatohet qartë se teksti përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga kjo dispozitë në pikat 2 deri në 5 të saj. Konkretisht, duke ndjekur edhe rrjedhën e normës, vendimi përmban: pjesën *hyrëse* – emërtimin zyrtar të Komisionit, trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësën administrativ, orën dhe vendin e vendimit të dhënë, emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, mendimin e subjektit të rivlerësimit; elementet e pjesës *përshkruese-arsyetuese* – rrethanat e çështjes të vlerësuara dhe përfundimet e nxjerra për secilën prej tyre nga trupi gjykues, provat e analizuar dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, njohjen nga trupa gjykuese e raportit dhe rekomandimit të relatores, dispozitat ligjore në të cilat mbështetet shqyrtimi i kriterëve dhe vendimmarrja; dhe së fundmi, elementet e pjesës *urdhëruese* – masën disiplinore të vendosur, të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.

19.2. Vendimi i Komisionit është në përputhje edhe me udhëzimet e jurisprudentës së Gjykatës Kushtetuese, shtjelluar në vendimin nr. 28, datë 15.05.2014. Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se:

[...] Vendimi gjyqësor [...] duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe ato duhet të

¹⁷ *Shih Uçar v. Turkey (dec.)*.

¹⁸ *Shih Beian v. Romania (no. 1), §§ 37 and 39; Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], §§ 116-35*.

¹⁹ *Vendimi nr. 28/2014*.

²⁰ *Neni 57 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 2. Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. 3. Hyrja e vendimit përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësën administrativ; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij. 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij”.*

formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, vlerësimi i zbatimit të këtij parimi bëhet rast pas rasti, pasi detyrimi i gjykatave për ta respektuar atë ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (shih vendimet nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese) [...]”.

19.3. Në pretendimet e tij në ankim, subjekti nuk ilustron në ç’menyrë apo në cilën pjesë vendimi i Komisionit bie ndesh me detyrimet ligjore dhe jurisprudenciale të formës dhe përmbajtjes së arsyetimit. Subjekti i rivlerësimit, po ashtu nuk ka ilustruar pretendimin e tij me pjesë të arsyetimit që janë alogjike dhe inkoherente me të tërën. Duke pasur parasysh sa rezulton nga analiza e mësipërme e trupit gjykues [shih paragrafët 19, 19.1 dhe 19.2.] dhe duke mos konstatuar probleme të formës, arsyetimit apo mungesës së logjikës në arsyetimin e Komisionit, nga njëra anë, dhe në analizë edhe të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit që lidhet me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, të analizuar në paragrafin 20, më poshtë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen këtë pretendim të pabazuar në ligj dhe në fakt.

- 20.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyetimi i vendimit të Komisionit është në kundërshtim me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, edhe sepse, sipas tij: a) nuk janë paraqitur mbi 90% e provave duke e vendosur atë vetë në kushtet e pabarazisë së armëve në gjykim e, për pasojë, në arritjen e konkluzioneve të pambështetura në provat e dosjes; b) nuk është përcaktuar dispozita ligjore dhe shkelja konkrete ligjore, si bazë për shkarkim nga detyra; c) argumentet nuk janë në unitet dhe të lidhura ngushtë ndërmjet tyre, të pabazuara në fakte ose në prova të reja, veç atyre të depozituara nga subjekti dhe nga organet e tjera: ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja; ç) vendimi është nul dhe i paarsyetuar me prova në ligj, pasi nuk është në përputhje me standardin strukturor që parashikon Kodi i Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”) në nenin 310, paragrafi II), pika 2²¹ pasi nuk përmban provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.

20.1. Në vijim, përpos arsyetimit në paragrafin 19, nga leximi i tekstit të vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka referuar dokumentacionin e marrë në shqyrtim në funksion të analizës së kryer dhe, pavarësisht se nuk i ka renditur në tekst individualisht të gjitha aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit²², ato janë administruar nga Komisioni²³. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit është kontradiktor dhe bie ndesh me

²¹ K.Pr.Civile në nenin 310, paragrafi II, pika 2 parashikon: “Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. [...] II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: [...] 2. provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi [...]”.

²² Deklaratën noteriale, datë 08.12.2018, të fëmijëve të K.Ç, për heqje dorë nga pasuritë e trashëguara, ose planimetrinë e hartuar nga ing.gjeod. B. A, datë 15.12.2018, përshkrimi teknik, datë 16.12.2018, nga ing. D. B, dokumentacioni i paraqitur për të kundërshtuar gjetjet e 5 dosjeve të shqyrtuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.

²³ Vendimi i Komisionit, faqe 9, 10 dhe 11, ndër të tjera, përmban një listë prej katër (4) dokumentesh për pasurinë tokë arë, si dhe një listë prej tri (3) dokumentesh mbështetëse të sjella nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me shtëpinë e banimit në fshatin {***} dhe vlerën provuese të asociuar atyre nga Komisioni në arsyetimin në vijim. Më tej, në faqen 13, Komisioni shprehet: “[...] Pasi dëgjoji subjektin në seancë, shqyrtoi provat dhe shpjegimet e tij të paraqitura me shkrim, Komisioni, megjithëse pamjet e fotografuara nuk janë shumë të qarta, i pranon këto shpjegime të subjektit, pasi nuk sheh prova të kundërta [...]”. Edhe në lidhje me shtëpinë dhe shtesën e katit në Sarandë, Komisioni ka listuar individualisht dokumentacionin mbështetës të sjellë nga subjekti i rivlerësimit në total tetë (8) nënpikash – shih faqen 14 të vendimit – pasuar me arsyetimin mbi këtë pasuri bazuar në këto dokumente në faqen 15. E njëjta situatë paraqitet edhe në lidhje me pasurinë ambient magazinë

faktet në ankim kur pretendon se Komisioni nuk përmend dhe as u referohet provave të paraqitura prej tij bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ndërsa njëkohësisht sjell në vëmendje që Komisioni nuk i ka kundërshtuar provat e sjella prej tij²⁴. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Është po ashtu i pabazuar pretendimi mbi mungesë të dispozitës ligjore mbështetëse për shkarkim. Procesi i rivlerësimit të subjektit është kryer për të tria kriteret. Në fund të procesit, siç duket qartë në faqen 46 të vendimit, Komisioni ka konkluduar se shkarkimi i subjektit bazohet në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 – deklaram i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe figurës dhe për cenim të besimit të publikut. Rezulton se pavarësisht çështjeve për të cilat Komisioni ka konstatuar probleme – referuar seksionit “Konkluzioni Përfundimtar” në faqen 45 të vendimit – masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është bazuar vetëm në dy pika të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

20.2. Pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit, lidhur me argumentet, formën dhe përmbajtjen e vendimit të Komisionit, janë analizuar gjerësisht në paragrafin 19 të këtij vendimi dhe janë gjetur të pabazuara në ligj dhe në fakt.

21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 1, 2, 3, 16 pika 12, 27, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 41 pika 3 dhe 4, 41 pika 1, 43, 44, 49 pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, 52 e 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016. Komisioni, sipas subjektit, i ka atribuuar vetes kompetenca që u përkasin organeve të tjera, që ligji ia njeh vetëm kur evidentohen fakte të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

21.1. Nga shqyrtimi i vendimit konstatohet se Komisioni ka analizuar raportet e dorëzuara nga institucionet e pavarura dhe ndihmëse, e konkretisht ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe IKLD-ja, dhe ka kryer hetim të pavarur për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e nevojshme në procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Sipas të njëjtës dispozitë, institucionet e rivlerësimit kanë akses të gjerë në informacion të ruajtur nga ente publike dhe private në drejtim të kontrollit të secilit prej kriterëve të rivlerësimit, që përfshin dosjet personale, pasuritë, gjendjen gjyqësore, transaksionet bankare, kalimin e kufirit, dhe të tjera të dhëna, ndër të tjera. Këtij aksesit të institucioneve të rivlerësimit i korrespondon detyrimi i entiteteve publike dhe private për të vënë në dispozicion informacionin e disponuar brenda një afati të caktuar kohor. Ligji parashikon edhe pasoja, në rast mungese bashkëpunimi. Me fjalë të tjera, në ngritjen e procesit të rivlerësimit, ligjvënësi i ka treguar kujdes të veçantë rëndësisë së hetimit nga institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, për të siguruar saktësinë e informacionit dhe për të garantuar të drejtat e subjekteve të rivlerësimit në funksion të misionit të procesit – kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Sa më sipër, zbatuar

(faqe 22 e vendimit), pasurinë truall 400 m² (faqe 23 e vendimit), për ambientin me sipërfaqe 30 m² në Sarandë (faqe 24 e vendimit). Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni referon në tekst dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti, sikurse kopja e faqes së regjistrit themeltar të punonjësve nr. 5 (faqe 28 e vendimit), informacionin e kancelarit të gjykatës (faqe 29 e vendimit), si dhe vendime gjyqësore lidhur me pronat e disponuara me vendime gjyqësore në {***} dhe {***}. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni referon në tekst kontratën e huas nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 13.02.2013, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 22.10.2016 (faqe 42 e vendimit), komunikimin shkresor për adresimin e pasqyrimit të gabuar të emrit të tij në sistemin elektronik të gjykatës (faqe 45 e vendimit), si dhe në tërësi dokumentacionin e paraqitur prej tij për të provuar pretendimet, kryesisht në pjesën arsyetuese mbi faktet e denoncimeve ndaj tij (faqe 41 – 44 e vendimit).

²⁴ Dokumentacioni i referuar në ankim i bashkëlidhur deklaratës “vetting”, lidhur me pasurinë në Sarandë që sipas subjektit nuk përmendet nga Komisioni (faqe 27 – 28 dhe 51 e ankimit), gjendet i pasqyruar në paragrafin 3/1, faqe 14 e vendimit të Komisionit.

në rrethanat e hetimit administrativ, parashikohet që Komisioni ka tagrin që pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të mëtejshme për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezultojnë nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Subjekti i rivlerësimit, si edhe gjetkë në ankim, nuk ilustron cilat veprime të Komisionit kanë përbërë tejkallim të tagrave. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se veprimet e kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit kanë qenë në përputhje me përcaktimet kushtetuese dhe ato ligjore. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka marrë kompetenca që u përkasin organeve të tjera, nuk qëndron.

22. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka identifikuar personin anonim mbi bazën e të cilit ka ngritur të gjitha pyetjet në relacionin përfundimtar për të tria kriteret e vlerësimit. Ky pretendim i subjektit është i pambështetur në ligj dhe në rrethanat e faktit. Identifikimi i saktë i personit anonim nuk është përgjegjësi e institucioneve të rivlerësimit. Përgjegjësi e institucioneve të rivlerësimit është analiza e fakteve të pretenduara nga denoncuesit. Neni 53, pika 1 parashikon:

“[...] 1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim [...]”.

22.1. Leximi në tërësi i nenit 53 tregon se kontrolli i statusit të identitetit të denoncuesit, nëse anonim apo i njohur, është një veprim fillestar me natyrë konstatuese. Në kontrast me këtë parashikim të sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, nga ana tjetër, ligjbërësi ka parashikuar me hollësi në katër [4] paragrafët në vijim të drejtën e çdo personi për të informuar institucionet e rivlerësimit mbi faktet ose rrethanat që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit. Ligji parashikon më tej që edhe heqja dorë e një individi nga raportimi i fakteve apo rrethanave nuk passjell pushimin e hetimit nga institucionet e rivlerësimit në rast se çmojnë që praktika e dyshuar përmban shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht. Denoncimi i fakteve dhe rrethanave nga persona të njohur apo anonimë shërben si burim informacioni që ndihmon organet e rivlerësimit për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjet e shqyrtuara gjatë procesit të rivlerësimit. Për analogji të rëndësisë së pjesëmarrjes së publikut në denoncimin e fakteve dhe specifikës që paraqet procesi i rivlerësimit, ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” – në përputhje me standardet e të cilit mbrohen të drejtat dhe interesat e denoncuesve, sipas nenit 53, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 – parashikon shprehimisht se: *[...] sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit [...].*

22.2. Nga aktet e administruara, rezultojnë se Komisioni ka kryer hetim mbi faktet dhe rrethanat e paraqitura në katër (4) denoncime (2 prej të cilave anonime), pas analizës së të cilave ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka reflektuar cilësi të dobëta në gjykim dhe arsyetim, ka kryer deklarime të rreme përpara Komisionit dhe ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, qoftë edhe në dukje, duke cenuar rëndë etikën dhe figurën e gjyqtarit. Në analizë të fakteve të pretenduara nga denoncuesit, Komisioni i ka dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit të njihet me to dhe të japë shpjegimet e tij, në përgjigjet e pyetësorit të datës 06.11.2018²⁵ [lidhur me njohjen me z. H. Ç] dhe pas rezultateve të hetimit administrativ [faqe

²⁵ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 07.11.2018.

29 – 40 e shpjegimeve të datës 24.12.2018]. Këta hapa të ndjekur nga Komisioni në procesin e hetimit administrativ në raport me denoncimet e publikut janë në përputhje me dispozitat që rregullojnë kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale. Në mënyrë specifike, neni 43 i ligjit nr. 84/2016 u rezervon një peshë me rëndësi denoncimeve të publikut në vlerësimin e profesionalizmit të subjekteve, përpos vlerësimit të përcjellë në raportin e KLD-së. Konkretisht, nëse vjen në dijeni mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit nga publiku nëpërmjet denoncimeve, relatori i çështjes ka tagrin që të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale²⁶. Nga shqyrtimi i vendimit rezulton që Komisioni është bazuar jo vetëm në shqyrtimin e fakteve të denoncuara, por edhe në shqyrtimin e rrethanave dhe të fakteve që kanë rezultuar nga aktet e administruara, si dhe në raportet e institucioneve ligjzbatuese. Nga analiza e fakteve të pretenduara në denoncim, Komisionit i rezultoi se subjekti gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, çka përbën një rrethanë ndikuese në vlerësimin e tij në raport me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, lidhur me etikën dhe cenimin e besimit të publikut. Për rrjedhojë edhe përkundër rrethanave faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se hetimi dhe vlerësimi i Komisionit janë bazuar vetëm në faktet e denoncimit anonim nuk qëndron. Hetimi ka qenë tërësor dhe është kryer në respektim të garancive të procesit të rregullt që dikton procesi i rivlerësimit.

23. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 13 e 14 të KEDNj-së dhe me nenin 1 të Protokollit 12 (shtesë), duke cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat e subjektit pasi nuk ka kryer analizë të dispozitave ligjore procedurale dhe materiale dhe se ka marrë një vendim haptazi të paarsyetuar, jo koherent dhe me mungesë përfundimesh logjike.

23.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të të drejtave të sanksionuara në nenet 6, 13 dhe 14 të KEDNj-së janë të pabazuara në prova. Në vijim edhe të arsyetimit të shtjelluar në paragrafët 14, 16, 17 dhe 18 të këtij vendimi, ndër të tjera, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNj-së). Subjekti ka gëzuar të gjitha garancitë procedurale që lidhen me mundësinë për të dhënë shpjegime me shkrim dhe me gojë gjatë procesit të hetimit administrativ, kohën e nevojshme për të paraqitur prova dhe dokumente, si dhe mundësinë për të njohur dosjen e administruar nga Komisioni [shih edhe kronologjinë kohore në paragrafin 12.1 më sipër]. Po kështu, gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova të reja. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka respektuar garancitë kushtetuese dhe parimet ndërkombëtare të mishëruara nga KEDNj-ja që lidhen me barazinë përpara ligjit, kontradiktorialitetin, mundësinë dhe kohën e nevojshme për t'u mbrojtur, parime që së bashku përbëjnë themelin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

23.2. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit sipas të cilit është shkelur neni 13 i KEDNj-së, i cili garanton të drejtën për zgjidhje efektive para një organi kombëtar, nuk specifikon cilën të drejtë të shkelur duhet të kishte zgjidhur Komisioni. Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, garancitë që ofron neni 13 i KEDNj-së për një zgjidhje efektive të çdo shkeljeje të pretenduar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit i gëzon nëpërmjet paraqitjes së ankimit në Kolegji²⁷. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 është shprehur se: “Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i

²⁶ Neni 43, pika 4 parashikon: “[...] Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale [...]”.

²⁷ https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SOI.pdf:

posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (*shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias*)²⁸.

23.3. Në vazhdim të analizës së mësipërme për sa i përket pretendimit për diskriminim [paragrafi 18] dhe duke rikonfirmuar atë analizë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se subjekti i rivlerësimit nuk ka shtjelluar se si dhe në çfarë baze pretendon shkeljen e nenit 14 të KEDNj-së dhe, ç'është më e rëndësishmja, nuk rezulton që ky subjekt të ketë gëzuar ndonjë nga të drejtat specifike të cilat synon të mbrojë kjo dispozitë, si: nuk rezulton të jetë provuar apo pretenduar një diskriminim për shkak seksi apo përkatësie fetare, përkatësie etnike etj. Nuk rezulton që subjekti të pretendojë ekzistencën e ndonjërit prej karakteristikave që qëndrojnë në themel të mbrojtjes nga neni 14 i Konventës apo që Komisioni të ketë diskriminuar subjektin për shkak të ndonjë cilësie të përfshirë në këtë standard ndërkombëtar. Përfundimisht, nga aktet e administruara apo nga ankimi, nuk rezulton që Komisioni të ketë shkelur të drejtat e mbrojtura dhe subjekti ka gëzuar garancitë e barazisë para ligjit në kuptim të nenit 14 të KEDNj-së.

23.4. Arsyetimi i mësipërm vlen edhe për pretendimin e subjektit që lidhet me shkelje të nenit 1²⁹ të Protokollit 12 të KEDNj-së. Meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk parashtron cilat baza përkatësie apo asocimi të mbrojtura nga këto dy burime të së drejtës ai posedon e që kanë përbërë shkas për diskriminim ndaj tij, dhe as nuk shtjellon cilat veprime të Komisionit kanë përbërë shkelje të këtyre garancive në procesin e rivlerësimit të kryer për të, trupi gjykues i Kolegjit kreu një analizë të këtij pretendimi të subjektit në parim, mbështetur në jurisprudencën e GjEDNj-së³⁰. Parë edhe në këndvështrimin parimor dhe jurisprudencial, kundrejt shkaqeve të ankimit, as ekzistenca e ndonjërit prej katër elementeve që duhet të provohen për të vlerësuar se ka ndodhur shkelje, nuk rezulton e bazuar. Konkretisht, subjekti nuk rezulton të jetë diskriminuar për shkaqe përkatësie në një të drejtë të shprehur apo të nënkuptuar, në ndonjë vendimmarrje diskrecionare nga entitetet publike dhe as nga veprime apo mosveprime të autoriteteve publike³¹.

Asnjë nga këto elemente nuk mund të argumentohet se gjen zbatim për subjektin e rivlerësimit, edhe analizuar në këndvështrimin ligjor në kontekstin e diskriminimit direkt apo

²⁸ *Shih paragrafin 66 të vendimit nr. 2/2017 në:*

http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php. Të njëjtën qasje ka shprehur edhe Komisioni i Venecias në opinionin e tij CDL-AD (2016)036, në paragrafin 63 të tij, ku Kolegji konsiderohet një juridiksion i specializuar që paraqet garanci gjyqësore për subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit. *Shih edhe:*

[https://www.venice.coe.int/ebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/ebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

²⁹ Neni 1 i Protokollit 12 parashikon: "1. Gëzimi i të drejtave të mbrojtura me ligj do të sigurohet pa asnjë diskriminim mbi baza të tilla, si: përkatësia gjinore, raciale, ngjyre, gjuhe, besimi fetar, mendimi politik apo mendim tjetër, origjina etnike apo shoqërore, asocimi me një pakicë etnike, gjendjeje pasurore, lindjeje apo status tjetër. 2. Askush nuk do të diskriminohet nga asnjë entitet publik mbi bazat e përmendura në paragrafin 1."

³⁰ "Savez crkava "Riječ života" and Others v. Croatia, 2010, §§ 104-105)".

<http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-102173>. *Shih edhe Udhëzimin mbi nenin 14 të KEDNj-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, botimi i parë, 31 dhjetor 2019. [Guide on Article 14 of the European Convention on Human Rights and on Article 1 of Protocol No. 12 to the Convention, first edition, 31 December 2019]. https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_14_Art_1_Protocol_12_ENG.pdf.*

³¹ Po aty. § 22 i Raportit Shpjegues, ndër të tjera: "[...] Sipas Raportit Shpjegues të Protokollit nr. 12, gama e mbrojtjes që ofron ky nen u përket katër (4) kategorive të çështjeve, e në veçanti, "ku një individ është diskriminuar: 1. në gëzimin e një të drejte të njohur në mënyrë të shprehur një individ sipas ligjit vendas; 2. në gëzimin e një të drejte e cila mund të nënkuptohet nga një detyrim i shprehur i autoriteteve publike sipas ligjit të vendit, që nënkupton që një autoritet publik ka një detyrim në bazë të ligjit të vendit të sillet në një mënyrë të caktuar; 3. nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecionar (për shembull, në dhënien e subvencioneve të caktuara); 4. nga ndonjë veprim ose mosveprim nga një autoritet publik (për shembull, sjellja e oficerëve ligjzbatues gjatë kontrollit të një proteste)[...]".

indirekt. Në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, procesit të rivlerësimit i janë nënshtruar të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë dhe në bazë të pikës 7, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, për të gjitha subjektet e rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit, për nga vetë natyra dhe qëllimi i përcaktuar që në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016 – funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë dhe rikthimi i besimit të publikut – është gjithëpërfshirës përkufizimisht. Ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes për subjektet e rivlerësimit që zgjedhin të mos rivlerësohen. Kushtetuta dhe ligji nuk parashikojnë asnjë diferencim apo trajtim preferencial. Kalimi me sukses i procesit garanton vazhdimin e qëndrimit të subjekteve në detyrë.

Së fundmi, meqenëse subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të mos shpjegojë bazat/cilësitë mbi të cilat bazohet pretendimi për diskriminim apo të shtjellojë sesi dispozitat kushtetuese që krijuan bazën e procesit të rivlerësimit dhe ligji nr. 84/2016 ka përbërë diskriminim të ndonjë forme për të, është e pamundur për trupin gjykues të Kolegjit të vlerësojë këtë pretendim edhe në analogji të jurisprudencës së GjEDNj-së kundrejt diferencës së trajtimit dhe justifikimit objektivisht për qëllime legjitime dhe në mënyrë proporcionale³². Në konkluzion të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në vendim nuk ruan renditjen e çështjeve si në relacionin mbi rezultatet e hetimit, duke krijuar mbivendosje, përzierje të përgjigjeve dhe pyetjeve me rezultatet e probleme të tjera që lidhen me logjikën e arsytimit edhe në raport me përgjigjet e tij pas kalimit të barrës së provës. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kuptim të ligjit nr. 84/2016, organet e rivlerësimit kanë detyrimin të respektojnë vetëm kërkesat e nenit 57 të tij. Arsytimi mbi përputhshmërinë e vendimit të Komisionit me kërkesat e kësaj dispozite është analizuar gjerësisht në paragrafët 19 dhe 20, më sipër. Së fundmi, renditja e çështjeve në relacion nuk krijon detyrim për organet e rivlerësimit për t'u ndjekur në hartimin e vendimit. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit mbetet i pakuptimtë.
25. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni është paragjykes dhe dukshëm i njëanshëm në relacionin mbi rezultatet e hetimit [datë 04.12.2018], leximi i relacionit në seancën publike të datës 04.01.2019 është përkthyer në media si një lajm shkarkimi, ndërkohë që vendimi do të merrej në datën 08.01.2019. Trupi gjykues i Kolegjit vëren që edhe ky pretendim i subjektit është haptazi i pabazuar në ligj dhe në fakte. Së pari, seanca dëgjimore në Komision është publike³³. Gjykata dhe, për pasojë, edhe Komisioni mund të mos lejojë pjesëmarrjen e mediave dhe të publikut në seancë gjyqësore ose në një pjesë të saj, vetëm si përjashtim nga rregulli, vetëm për shkak të mbrojtjes së moralit publik, rendit publik, të sigurisë kombëtare, të sekretit tregtar, të së drejtës së jetës private ose të të drejtave vetjake. Nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 04.01.2019 nga Komisioni, konstatohet se kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit ka zbatuar parashikimet ligjore dhe nënligjore për publicitetin e seancave gjyqësore, përfshirë edhe rregulloren e Komisionit “Për median”³⁴. Në zbatim të këtyre dispozitave, kamerat kanë qenë të pranishme deri në dhënien

³² § 49, Udhëzimi mbi nenin 14 të KEDNj-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, faqja 15-19. “[...] Në vlerësimin nëse ka pasur diskriminim, Gjykata do të aplikojë testin e mëposhtëm: 1. A ka pasur diferencë në trajtimin e individëve në situata analoge ose të ngjashme për sa u përket rrethanave relevante – ose mungesë trajtimi të ndryshëm të individëve në situata rrethanash relevante të ndryshme? 2. Nëse po, a justifikohet objektivisht ky diferencim apo mungesë diferencimi? Në veçanti, a. Nëse kryhet për qëllim legjitim? b. A janë mjetet e përdorura arsyeshëm proporcionale me qëllimin e synuar?”

³³ Sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 20 të ligjit nr. 49/2012.

³⁴ Shih: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/11/Rregullore-per-Median.pdf>.

e fjalës relatorit. Më pas, mediat janë udhëzuar të ndalin regjistrimin zanor dhe viziv. Kryesuesja u ka kujtuar mediave ndalimin e regjistrimit apo fotografimit të pamjeve të subjektit të rivlerësimit apo publikut. Në kushtet që seanca është publike, diskutimet dhe deklaratat e palëve apo edhe të përfaqësuesit të ONM-së pasqyrohen në kohë reale nga media. Interpretimi dhe raportimi i seancës dhe përfundimet që nxjerr media bëjnë pjesë në garancitë kushtetuese tek e drejta e fjalës. Mënyra se si media e interpreton dhe raporton seancën është përtej tagrave të Komisionit dhe përbën një nga aspektet e publicitetit të gjyqimit. Nga procesverbali nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, i cili ka qenë i pranishëm në seancën dëgjimore, të këtë kërkuar seancë pa praninë e publikut, sipas nenit 20 të ligjit nr. 49/2012. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë pretenduar se leximi i rezultateve të hetimit administrativ nga relatorja është paragjykes apo i njëanshëm. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

26. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në shqyrtimin e çështjes Komisioni nuk është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke cenuar rëndë garancitë e procesit të rregullt ligjor, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë shpjegim në ankim për të mbështetur këtë pretendim. Për pasojë, edhe ky pretendim u analizua në nivel interpretimi ligjor të dokumentacionit të administruar nga Komisioni.

26.1. Trupi gjykues i Kolegjit, duke sjellë në vëmendje edhe gjetjet e shtjelluara më sipër për secilin pretendim të subjektit të rivlerësimit që i përket procesit të rregullt, përfshirë sidomos paragrafët 12 dhe 25, vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar. Sipas dispozitës në fjalë [neni 52 i ligjit nr. 84/2016]³⁵, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Më tej, neni 52 parashikon që subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova dhe dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën. Nga aktet në fashikull nuk rezulton që vetë subjekti të ketë pretenduar probleme procedurale në lidhje me kalimin e barrës së provës. Referuar gjetjeve të evidentuara nga Komisioni, që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe në konstatimin e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, është rrjedhojë direkte e parashikimeve ligjore. Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar në qëndrimin e shprehur për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016³⁶. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriteret e vlerësimit

I. Mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

27. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë pasi, sipas tij, ato nuk bazohen në asnjë provë të re lidhur me raportin e ILDKPKI-së, i cili del në përfundime të kundërta. Po ashtu, subjekti sjell në vëmendje se konkluzionet mbi kriterin e pasurisë nuk janë bazuar në provat e depozituara prej tij dhe janë të pambështetura në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës, ligjit të posaçëm nr. 84/2016 dhe kuadrit ligjor shoqëruar mbi të cilin bazohet procesi i rivlerësimit.

³⁵ Neni 52 përcakton parime mbi barrën e provës. Pika 1 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit [...]”.

³⁶ Shih vendimet nr. 34/2019, nr. 32/2019, 28/2019, 23/2019, 22/2019 etj.

27.1. Më në hollësi, argumentet e subjektit të rivlerësimit në shtjellim të këtij shkaku ankimi, të përmbledhura janë: Komisioni nuk e ka njoftuar lidhur me mangësitë e konstatuara që ta lejonte të përmbushte detyrimet, si dhe të dëgjohej e të mbrohej; Komisioni duhej të shprehej me vendim të ndërmjetëm në lidhje me provat e paraqitura në përgjigje të barrës së provës, nuk është shprehur për kërkesën e tij në seancën publike dhe në shpjegimet përfundimtare për këqyrje në vend të pasurive dhe për pasojë, Komisioni referuar parashikimeve kushtetuese, nuk ka luajtur një rol aktiv. Subjekti ka qenë dakord me përfundimet e hetimit sepse Komisioni nuk kishte asnjë provë të re. Ai vlerësoi se provat e paraqitura prej tij do të shqyrtoheshin, sipas nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Në të kundërt, sipas subjektit, Komisioni ka barrën e provës të provojë shkeljet e ligjit nga ana e subjektit të rivlerësimit. Komisioni duhet të caktonte ekspertë dhe të verifikonte dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e interesave privatë periodikë dhe në deklaratën *vetting*. Komisioni zbatoi vetëm formalisht parashikimet e nenit 87 të ligjit nr. 44/2015, ndërsa kishte detyrimin për “barrën e provës” që pas depozitimit të shpjegimeve të datës 24.12.2018, të shqyrtonte shpjegimet përpara seancës dëgjimore të datës 04.01.2019 dhe përpara se të dëgjohej, t’i bënte prezent subjektit të rivlerësimit, përveç rezultateve të hetimit, edhe *rezultatet e pritshme të procedurës administrative*, në zbatim të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015. Komisioni duhet t’i kalonte sërish barrën e provës subjektit për paqartësitë e konstatuara. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Pasuria e disponuar është e pandryshuar, është deklaruar plotësisht dhe saktësisht me dokumentacion ligjor të pandryshuar nga viti 2003 e në vazhdim, si dhe në deklaratën *vetting*. Shpenzimet janë vetëm ato që janë deklaruar. Subjekti ka kryer deklaratim të saktë në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaratim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave; dokumentacioni i dorëzuar është i njëjtë me gjetjet e konstatuara nga Komisioni; Komisioni, në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka gjetur mosjustifikim të të ardhurave në lidhje me krijimin e pasurisë, por vetëm është fokusuar në pasaktësitë e krijimit të akteve zyrtare që nuk janë krijuar prej tij dhe nuk kanë pasur asnjë qëllim të caktuar; ILDKPKI-ja ka kryer procedurën ligjore dhe nuk ka konstatuar asnjë nga përcaktimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; pasaktësitë në deklaratim (lapsuse, ngatërresa) përjashtojnë mundësinë e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit; praktika e ndjekur nga Komisioni për subjekte të tjera është e ndryshme, që e vendos atë në pozita diskriminuese. Subjekti u referohet vendimeve nr. 2/2018, nr. 47/2018, nr. 53/2018, nr. 62/2018, nr. 71/2018, nr. 79/2018, nr. 84/2018, nr. 90/2018, nr. 91/2018.

28. Argumentet e subjektit të rivlerësimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe me procedurat e ndjekura nga Komisioni janë trajtuar gjerësisht në paragrafët 12 – 26 të këtij vendimi, në Seksionin B. Për sa i përket vlerësimit në themel të këtyre argumenteve, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim aktet e administruara nga Komisioni gjatë procesit, përfshirë shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në përgjigje të barrës së provës. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit që vijon, ndjek rendin kronologjik dhe atë të pretendimeve të parashtruara në ankim.

i) Pasuria tokë arë, truall, ullishte, pemishte, me sipërfaqe të përgjithshme 17.540 m², përfshirë edhe 51 rrënjë ullinj shumëvjeçarë dhe 250 rrënjë ullinj dhe pemë frutore në disa parcela, në bashkëpronësi, fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991.

28.i. 1. Sipas subjektit të rivlerësimit, përfundimi i Komisionit³⁷ është i pabazuar në ligj dhe në shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ana e tij, pasi “Akti i marrjes së tokës në pronësi” [nr.

³⁷ *Shih faqen 10 të vendimit – “[...] subjekti nuk ka arritur të japë asnjë sqarim bindës apo të paraqesë prova në lidhje me mospërputhjen e sipërfaqes prej 500 m², shtëpi + truall të përfitur me AMTP-në, dhe përfitimit prej tij të sipërfaqes prej 600 m², sipas vërtetimit të Njësisë Administrative {***} të datës 13.10.2016 [...]”.*

{***}, datë 01.09.1994] ka për objekt ndarjen e tokës bujqësore dhe jo truallin. Shtëpia nuk është përfituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (për lehtësi reference në vijim “AMTP”). Sipërfaqja e truallit prej 500 m² nuk ka qenë objekt i ndarjes nga ligji nr. 7501/1991, për pasojë ai nuk kishte tagrin e pronarit edhe pse kjo sipërfaqe ishte pasqyruar në AMTP. Në kohën kur është hartuar AMTP-ja, subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues, nuk ka marrë sipërfaqe përtej normës që i takonte me ligj dhe nuk ushtronte funksion në Komisionin e Ndarjes së Tokës. Mosrakordimet ndërmjet institucioneve, lidhur me sipërfaqen e truallit, nuk mund t'i "faturohen" atij për efekt shkarkimi. Vërtetimi i Njesisë Administrative {***} [me nr. {***} prot.], datë 13.10.2016, i përmendur nga Komisioni, nuk është akti me të cilin subjekti ka fituar pronësinë. Pronësia është fituar me kontratën e dhurimit [nr. {***}992 rep. dhe nr. {***} kol.], të datës 11.06.1996. Vërtetimi i dytë i Njesisë Administrative {***} [me nr. {***} prot.], datë 01.11.2018, konfirmon arsyet përse AMTP-ja është në emrin e subjektit dhe faktin se kjo praktikë është ndjekur në të gjithë zonën që përfshin kjo njësi administrative nga komisionet e ndarjes së tokës. Në asnjë deklaratë vjetore apo edhe në deklaratën *vetting* nuk e ka deklaruar pjesën e të atit në pronësi të tij – ka sqaruar pjesën e tij takuese 1/6 pjesë të sipërfaqes totale. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje deklaratën noteriale [nr. {***} rep., nr. {***}kol.], datë 08.12.2018, nëpërmjet të cilës motrat dhe vëllezërit e tij kanë rënë dakord që pjesën e babait ta trashëgojë ai [subjekti i rivlerësimit]. Konstatimi i Komisionit se gjyqtarja [N. H.] që ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë me vendimin e datës 16.11.2004 ka punuar në të njëjtën gjykatë me subjektin e rivlerësimit, është i pakuptimtë dhe nënkupton ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi.

28.i.2. Nga dokumentacioni i administruar, që përkon me dokumentacionin mbi të cilin mbështeten pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, rezulton se me AMTP-në nr. {***}, datë 01.09.1994, subjekti i rivlerësimit ka përfituar tokë bujqësore në sipërfaqen 17540 m², në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” (në vijim “ligji nr. 7501/1991”). Kjo pronë përbëhet nga tokë arë – 15.800 m², ullishte – 1.240 m² dhe truall (me emërtesën e vendit ku ndodhet “shtëpi”) – 500 m². Sipas shkresës së Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Delvinë [datë 12.11.2018], toka në pronësi të K.Ç [i ati i subjektit të rivlerësimit] është e pasqyruar në AMTP-në në pronësi të Alltun Çela. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Delvinë të datës 12.10.1995, është vendosur njohja e pronësisë së K.Ç mbi shtëpinë e banimit të ndërtuar prej tij, në fshatin {***} të rrethit Delvinë, në një sipërfaqe trualli prej 600 m². Me vendimin e datës 16.11.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të K.Ç bashkëshorten dhe 5 fëmijët në mënyrë të barabartë, 1/6 pjesë të trashëgimisë së trashëgimlënësit. Më datë 08.12.2018³⁸, vëllai dhe motrat e subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar heqjen dorë nga të gjitha pasuritë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësit K.Ç (Ç).

28.i.3. Në analizë të saktësisë së deklaramit të kësaj prone, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e parë për vitin 2003 (dorëzuar më datë 15.03.2004), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e zotëron këtë pasuri në masën 100%, ndërsa në deklaratën *vetting* (dorëzuar më datë 26.01.2017) është shprehur se këtë pasuri e zotëron në masën 1/6 pjesë. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 31.10.2018³⁹, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pavarësisht se prindërit ishin në një trung familjar më vete, ka qenë praktikë e Komisionit të Ndarjes së Tokës në {***} që t'i vendoste edhe familjet e ndara në një AMTP të vetme. Si rrjedhojë, edhe toka që përfituan prindërit e tij u pasqyrua në emër të tij dhe i ati nuk ka poseduar AMTP tjetër.

³⁸ Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol.

³⁹ Pyetja nr. 15.

28.i.4. Sipas nenit 6 të ligjit nr. 7501/1991 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 02.08.1991 (në vijim “VKM 255/1991”), familjeve me banim në fshat që në kohën në fjalë nuk ishin anëtarë të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punonin e banonin në ndërmarrjet bujqësore, u jepej në përdorim tokë bujqësore sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991 sa $\frac{1}{2}$ e tokës për frymë të anëtarit të kooperativës bujqësore, por jo më shumë se 4 dynym për familje.

28.i.5. Nga zbatimi i këtyre dispozitave ligjore e nënligjore në raport me dokumentacionin e përmendur në paragrafin 28.i.2, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar në mënyrë të pasaktë pjesën takuese për këtë pasuri në pronësi të tij, e analizuar në dy mënyra alternative. Së pari, nëse referuar ligjit nr. 7501/1991 dhe VKM-së nr. 255/1991 kjo pasuri do të konsiderohet se përfshin vetëm familjen e subjektit të rivlerësimit, atëherë ai do të duhej ta deklaronte atë në masën $\frac{1}{4}$ pjesë takuese, meqenëse, sipas certifikatës familjare të datës 01.08.1991, subjekti i rivlerësimit rezulton vetë i 4-t dhe në cilësinë e kryefamiljarit. E njëjta pjesë takuese, konkretisht $\frac{1}{4}$ pjesë, do të duhej të deklarohet edhe në deklaratën *vetting*. Nga ana tjetër, nëse do të konsiderohet se AMTP-ja përfshinte pjesën takuese të prindërve të tij (2 frymë), sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe shkresave të Njësisë Administrative {***} dhe të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Delvinë, pjesa takuese për këtë pasuri e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 do të duhej të deklarohet në masën $\frac{1}{6}$ pjesë. Po kështu, në deklaratën e pasurisë për vitin 2004, subjekti duhet të deklaronte ndryshimin e pjesës takuese për shkak të shtesës me $\frac{1}{6}$ të rrjedhur nga dëshmia e trashëgimisë, lëshuar me vendimin e gjykatës të datës 16.11.2004. Në deklaratën *vetting*, pjesa takuese për këtë pasuri do të duhej të deklarohet $\frac{1}{6}$ pjesë takuese, si dhe $\frac{1}{6}$ e $\frac{1}{6}$ -ës pjesë takuese përfituar nga trashëgimia pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të datës 16.11.2004. Deklarata noteriale sipas të cilës trashëgimtarët e tjerë (motrat dhe vëllai) kanë deklaruar heqjen dorë nga të gjitha pasuritë e trashëguara nga babai i tyre, është hartuar rreth 18 muaj pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, më datë 08.12.2018. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në mënyrë të pasaktë në deklaratat e pasurisë për vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting*.

28.i.6. Trupi gjykues i Kolegjit vëren që pretendimi i subjektit se sipërfaqja truall 500 m^2 nuk ka qenë objekt i ndarjes së ligjit nr. 7501/1991, edhe pse kjo sipërfaqe ishte pasqyruar në AMTP, pasi shtëpia nuk është përfituar në bazë të AMTP-së, pranohet. AMTP-ja ka evidentuar se sipërfaqja truall ku ndodhet pasuria “shtëpi” prej 500 m^2 , është listuar si zë i veçantë në sipërfaqen totale që i është dhënë subjektit të rivlerësimit në bazë të ligjit nr. 7501/1991. Nga ana tjetër, rezulton se ndërmjet vërtetimit të Njësisë Administrative {***} (nr. {***}) dhe dokumentacionit që shoqëron AMTP-në ka mospërputhje me 100 m^2 . Sipërfaqja e truallit e evidentuar në AMTP pasqyrohet në madhësinë 500 m^2 , ndërsa në vërtetim në madhësinë 600 m^2 . Kjo e fundit përkon me vendimin e Gjykatës së Rrethit Delvinë të datës 12.10.1995, me anën e të cilit ka fituar pronësinë mbi truallin i ati i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri K.Ç. Vlen të theksohet se Njësia Administrative {***}, në vërtetimin e datës 13.10.2016, nuk shpjegon mbi ç’bazë sipërfaqja e truallit të shtëpisë është pasqyruar 600 m^2 , ndërkohë që sipas AMTP-së së cilës i referohet kjo shkresë, sipërfaqja e truallit të shtëpisë është pasqyruar në sipërfaqen 500 m^2 . Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim se nuk mund të mbajë përgjegjësi për mospërputhjet në të dhënat që pasqyrojnë shkresat nga institucione të ndryshme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo shkresë përbën paketën e dokumentacionit të sjellë prej tij bashkë me deklaratën e pasurisë [vetting]. Ky fakt nënkupton dijeni dhe pasqyrim të saktë të pasurisë sipas njohurive të subjektit. Në të kundërt, vetë subjekti do të duhet të kishte marrë masa, të saktësonte situatën duke kërkuar informacion shtesë dhe korrigjim të gabimeve. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se pretendimet dhe shpjegimet e subjektit për

mospërputhjen ndërmjet AMTP-së dhe vërtetimit të datës 13.10.2016 për sa i përket sipërfaqes së truallit me emërtimin “shtëpi”, nuk janë bindëse. Ky konstatim i trupit gjykues të Kolegjit ka në konsideratë edhe arsyetimin që vijon në paragrafin 28.ii për sa i përket shtëpisë dhe truallit, mbështetur në dokumentacionin e administruar për këtë truall, i cili në mënyrë konsistente referohet si 600 m².

*ii) Lidhur me pasurinë shtëpi banimi në fshatin {***} Delvinë, e ndërtuar para vitit 1990, regjistruar më datë 19.6.1996⁴⁰. Sipas subjektit, kjo pronë është e trashëguar, e krijuar para vitit 1990, kur subjekti nuk ishte gjyqtar dhe i është dhuruar nga i ati në vitin 1996.*

28.ii.1. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton si të pabazuara në ligj përfundimet e Komisionit për këtë pasuri⁴¹, duke pretenduar se sipërfaqja e shtëpisë në fshat përbëhet prej 100 m² ndërtim dhe 500 m² në funksion të saj dhe se kjo pasuri prej 600 m² është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në bazë të vendimit gjyqësor. Sipas subjektit, AMTP-ja nuk është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe, për të provuar këtë pretendim, subjekti përmend shkresën e Bashkisë Delvinë të datës 01.11.2018 dhe shkresën e ZVRPP Sarandë të datës 01.11.2018 (pyetja 15 e pyetësorit nr. 2). Sipas tij, nuk ka pasur qëllim të bëjë deklaram të rremë nëpërmjet deklaramit se shtëpia është e trashëguar dhe që atij ia ka dhuruar i ati, ndërkohë që nëse Komisioni dyshonte në vërtetësinë e deklaramëve të tij mund të këqyrte shtëpinë me ekspert. Sipërfaqja e truallit 600 m², e cila përfshin dhe sipërfaqen 100 m² të ndërtimit të shtëpisë, është pasuri e trashëguar nga babai i subjektit dhe jo e blerë. Sipërfaqja truall prej 600 m² përbëhet nga 100 m² shtëpi dhe 500 m² truall, referuar planimetrive të datës 17.08.1995 dhe të datës 15.12.2018. Kjo pasuri nuk është regjistruar në bazë të AMTP-së, pretendon subjekti, por në bazë të vendimit gjyqësor të datës 12.10.1995. Kërkesëpadia në gjykatë është bërë nga i ati. Referuar legjislacionit të kohës – nenit 77 të Kodit të Procedurës Civile⁴² – kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje ka qenë Gjykata e Rrethit Delvinë. Po kështu, subjekti i rivlerësimit kundërshton gjetjen e Komisionit lidhur me situatën e konfliktit të interesit të paktën në dukje për shkak edhe të shpejtësisë me të cilën u gjykua padia e të atit të tij, për më tepër që ai nuk kishte lidhje me gjykimin e çështjes. Fakti që gjykimi ka mbaruar në një kohë të shkurtër nuk është arsyeim ligjor dhe Komisioni do të duhej të referonte bazën ligjore që është shkelur.

28.ii.2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Delvinë më datë 30.03.1995. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Gjykata e Rrethit Delvinë më datë 12.10.1995 ka pranuar padinë që i përket paditësit K.Ç, me të paditur Komuna {***} dhe me objekt “Njohje pronësie mbi një shtëpi banimi, të ndërtuar nga unë, në fshatin {***}, me një sipërfaqe trualli 600 m², konform nenit 86 të K.P.Civile”. Sipas vendimit në fjalë [nr. {***}], paditësi e ka ndërtuar shtëpinë me leje të

⁴⁰ Nr. 5, faqe 14 indeksi, nr. {***}, ZVRPP Sarandë.

⁴¹ Shih faqet 13 - 14 të vendimit – “[...] Mbetet ende e paqartë se si shtëpia + truall e pasqyruar në AMTP me sipërfaqe 500 m², u regjistrua me vendim gjykate me sipërfaqe 600 m², pra, 100 m² më shumë; Subjekti ka kryer deklaram të rremë përpara Komisionit për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga babai i subjektit, duke e konsideruar këtë shtëpi si trashëgimi, gjë që bie ndesh me vendimin nr. {***}, datë 12.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë; Subjekti nuk arriti të bindë Komisionin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë, kryetar i së cilës ishte vetë subjekti, ishte e vetmja gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës së babait të subjektit për njohjen pronar të shtëpisë në fshatin {***}, duke shkaktuar kështu një konflikt interesi të paktën në dukje, të nxitur edhe më shumë nga shpejtësia me të cilën u vendos ky rast dhe u vendos në favor të babait të subjektit [...]”.

⁴² Neni 77 i ligjit nr. 6341, datë 27.06.1981, parashikon: “Padia që ka lidhje me sende të paluajtshme, me pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe me nëdorësinë, paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet që lindin nga ekzekutimi i detyrueshëm i detyrimeve, si dhe ato që kanë lidhje me trashëgiminë, ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet, pasuria trashëgimore, a pjesa më e madhe e tyre ose ku trashëgimlënësi ka pasur banimin në kohën e vdekjes”.

organeve shtetërore të kohës, pasi më parë nuk ka pasur shtëpi. Sipas vendimit, gjatë hetimit gjyqësor u provua se paditësi ka ndërtuar “me forcat e tij” një shtëpi banimi prej vitit 1956. Gjykata mbështet gjetjen se shtëpia është e paditësit K.Ç edhe në thëniet e dëshmitarëve dhe “dokumentet shkresore të paraqitura në seancë”. Vendimi nuk citon dhe as riprodhon dokumentacionin shkresor mbi të cilin bazohet. Me kontratën e dhurimit, datë 11.06.1996⁴³, K.Ç, “pronar i një shtëpie banimi si dhe trualli që zë ajo, dhënë në funksion të banesës”, ia dhuron këto prona subjektit të rivlerësimit Alltun Çela. Trualli që dhurohet ka një sipërfaqe prej 600 m². Sipas kontratës, pronësia e dhuruesit bazohet në vendimin e Gjykatës së Rrethit Delvinë nr. {***}, datë 12.10.1995. Shkresa e ZVRPP Sarandë, gjatë hetimit administrativ [datë 07.02.2018] konfirmon se në pronësi të subjektit të rivlerësimit rezulton, ndër të tjera, pasuria shtëpi banimi dhe trualli me sipërfaqe 600 m² në {***}, të regjistruara në bazë të kontratës së dhurimit të datës 11.06.1996, me pronar të mëparshëm K.Ç.

28.ii.3. Në ankim subjekti deklaron se shtëpia është e trashëguar, duke shtuar edhe:

*[...] Familja ime [...] ka jetuar në fshatin {***} të Delvinës. Aty ndër breza ka pasur edhe tokën e vet ku ka qenë ndërtuar shtëpia e cila është djegur dhe rindërtuar të paktën 1 herë nga viti 1914 [...]. Pas daljes nga burgu politik, babai im ndërtoi një shtëpi më të madhe në themelet e shtëpisë së vjetër të trashëguar në breza, shtëpi e rrënuar [...]*”.

28.ii.4 Trupi gjykues i Kolegjit rikujton se, siç është shtjelluar më sipër në paragrafët 28.i.2 dhe 28.i.6, AMTP-ja nr. {***} pasqyron edhe pasurinë “shtëpi” me truall 500 m². Vetë subjekti e pranon në ankim se AMTP-ja dhe vendimi i Gjykatës Delvinë nr. {***}, datë 12.10.1995, bëjnë fjalë për të njëjtin truall, pasi babai i tij ka pasur vetëm një shtëpi, që është e njëjta pasuri. Me fjalë të tjera, ndërsa sipas AMTP-së në emrin e subjektit të rivlerësimit evidentohet se sipërfaqja e *truallit* ku ndodhet shtëpia është me sipërfaqe 500 m², sipas vendimit të gjykatës, pronësia mbi *shtëpinë*, shoqëruar me një sipërfaqe trualli prej 600 m², i është njohur babait të tij. Vendimi i gjykatës, për sa u përket 600 m², përfshin sipërfaqen e truallit mbi të cilën ndodhet banesa që është në tejkalim të sipërfaqes prej 500 m² të pasqyruar në AMT në Pronësi nr. {***}.

28.ii.5. Në analizë të paragrafit pararendës, trupi gjykues i Kolegjit konstaton mospërputhje të dukshme, të paargumentuara bindshëm, nga subjekti i rivlerësimit midis të dhënave të pasqyruara në vendimin gjyqësor dhe të dhënave të pasqyruara në aktin e marrjes së tokës në pronësi, lidhur me sipërfaqen e disponuar. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arrijnë të zhbëjnë këtë konstatim. Pretendimi i subjektit se sipërfaqja truall prej 600 m² përbëhet nga 100 m² shtëpi dhe 500 m² truall, ku sipërfaqja e truallit në funksion të banesës nuk përlllogaritet, është alogjik. Po kështu, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar sipërfaqen që përbën trualli dhe banesa.

28.ii.6. Pretendimi se shtëpia përbën pasuri të trashëguar *ndër breza*, i ngritur në ankim, jo vetëm nuk ndihmon në qartësimin e situatës, por është i paprovuar me dokumentacion ligjor dhe bie ndesh me deklaratat e mëparshme të subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, në deklaratën fillestare të interesave privatë për vitin 2003 dhe në atë *vetting*, burim i kësaj pasurie është deklaruar kontrata e dhurimit e datës 11.06.1996, ndërsa origjina – banesë e vjetër sipas vendimit gjyqësor të datës 12.10.1995. Edhe nga përmbajtja e këtij vendimi të Gjykatës së Rrethit Delvinë për njohjen e pronësisë babait të subjektit, nuk rezulton që pasuria objekt njohjeje pronësie të jetë e trashëguar. Po ashtu, në vendimin e gjykatës nuk pasqyrohet sa ka qenë sipërfaqja e truallit dhe e ndërtesës në vitet 1956 dhe 1970, kur është lejuar nga organet kompetente që të ndërtohej. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson

⁴³ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se deklarimi i tij për këtë pasuri është i rregullt, nuk qëndron.

28.ii.7. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me disa aspekte të vendimit të Komisionit që kanë të bëjnë me shqyrtimin e kësaj çështjeje nga Gjykata e Rrethit Delvinë në vitin 1995, bazohet në dispozitat procedurale civile, të cilat ishin në fuqi në tetor 1995⁴⁴. Së pari, për sa i përket konkluzionit se subjekti nuk e bindi Komisionin se asnjë gjykatë tjetër nuk mund ta shqyrtonte padinë e babait të subjektit për njohjen e pronësisë më 12.10.1995, trupi gjykues i Kolegjit arrin në një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni. Meqenëse dispozitat procedurale civile parashikonin se padia për sendet e paluajtshme duhet të ngrihej në vendin ku ndodhen sendet, kompetente në rastin konkret ishte Gjykata e Rrethit Delvinë. Këto dispozita nuk përmbanin parashikime ligjore që lidhen me transferime/dërgime për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga njëra gjykatë në tjetrën, nëse gjyqtari/kryetari i asaj gjykate është palë apo ka interes në atë të çështje.⁴⁵ Në nenin 62 të K.Pr.Civile, sipas ndryshimeve të datës 19.04.1995⁴⁶, parashikohet se paditë për njohjen dhe kërkimin e pronësisë dhe të drejtat reale mbi pronësinë shqyrtohen në gjykatën e rrethit me trup gjykues të përbërë nga 1 gjyqtar dhe 2 ndihmësgjyqtarë. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit duhet pranuar.

28.ii.8. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se disa elemente të tjera të vendimmarrjes nga Gjykata e Rrethit Delvinë për njohjen e kësaj pronësie, të shqyrtuar së bashku në kontekstin e këndvështrimit të një vëzhguesi objektiv, përbëjnë shkak për të arritur në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet nga analizimi tërësor i disa procedurave dhe rrethanave faktike.

28.ii.9. Nga dokumentacioni i administruar dhe parashtrimet e subjektit, mbetet përtej kontestimit një situatë faktike e përmbledhur si vijon.

- a) Gjykata që drejtonte subjekti i rivlerësimit i ka njohur pronësinë të atit të tij mbi një shtëpi në një sipërfaqe trualli të evidentuar një vit më herët nga AMTP-ja, të lëshuar në emër të vetë subjektit. Kjo pronë, pak muaj më pas, i është dhuruar vetë subjektit të rivlerësimit.
- b) Vendimi gjyqësor është dhënë brenda një kohe veçanërisht të shkurtër [6 ditë] nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, edhe në raport me afatet më të shkurtra që parashikonte ligji [20 ditë] për kategori specifike procedimesh civile që për nga natyra kërkonin përparësi.
- c) Në deklaratat e interesave privatë për vitin 2003, kur është deklaruar për herë të parë kjo pasuri, dhe në atë të pasurisë (*vetting*), subjekti ka zgjedhur të mos shprehet për sipërfaqen e kësaj pasurie.

28.ii.10. Me fjalë të tjera, pak muaj pas emërimit të subjektit të rivlerësimit kryetar, gjykata që ai drejtonte i ka njohur babait të subjektit të rivlerësimit pronësinë mbi një shtëpi dhe ka tejkualuar kufijtë e dokumentacionit ligjor me 100 m², brenda gjashtë ditësh pune [regjistruar më 06.10.1995 dhe gjykuar më 12.10.1995] sipas ligjit të kohës. Procedimi me një përparësi të tillë është në kontrast jo vetëm me afatin njëmuor, parashikuar nga ligji për çështjet e zakonshme civile, por edhe me çështjet për të cilat ligji ka parashikuar afatet më të shpejta –

⁴⁴ Ligji nr. 6341, datë 27.06.1981, i ndryshuar me ligjin nr. 7537/1991.

⁴⁵ Edhe Kodi i Procedurës Civile i miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, nuk ka sjellë parashikime që të normojë këtë lloj situatë. I vetmi parashikim për transferim në të dy kodet lidhet me shpejtësinë apo lehtësinë e procedimit dhe kur vendqëndrimi ose vendbanimi i të paditurit është i panjohur.

⁴⁶ Ligji nr. 7922, datë 19.04.1995, "Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 7537, datë 17.12.1991, "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë".

20 ditë për paditë e largimit nga puna sipas nenit 103 të Kodit të Procedurës Civile në fuqi⁴⁷ [tetor 1995]. Kjo dispozitë parashikonte, ndër të tjera, se çështjet civile që *nuk* kanë të bëjnë me zgjidhje martesë, largim nga puna apo pjesëtim pasurie, i nënshtrohen një afati “jo më vonë se 1 muaj [...] duke filluar afati për çdo rast nga dita e ardhjes së çështjes në gjykatë [...]”. Sa më sipër, pavarësisht se çështjet gjyqësore me objekt njohjen e pronësisë nuk ishin objekt i procedimit të shpejtë, Gjykata e Rrethit Delvinë ka proceduar me shpejtësi të “admirueshme” – brenda 6 ditëve – ndërkohë që afati ka qenë një (1) muaj – dhe ka disponuar me sipërfaqe trualli përtej AMTP-së.

28.ii.11. Parë së bashku, të gjitha këto fakte krijojnë një situatë të paktën në dukje konflikti interesi. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që legjislacioni që rregullon dhe parandalon konfliktin e interesit ka hyrë në fuqi në vitin 2005. Nga ana tjetër, duke vlerësuar në tërësi shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe mënyrën se si e ka deklaruar sipërfaqen, si dhe veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për përfitimin e pasurisë, janë të tilla që diktojnë një gjendje të cenimit të besimit të publikut te drejtësia. Në kushtet kur subjekti ushtronte detyrën e kryetarit të gjykatës, veprimet e përshkruara më sipër, në këndvështrimin e një vëzhguesi të thjeshtë, e bëjnë të pashmangshme mungesën e besimit te drejtësia dhe shteti ligjor. Fakti që Gjykata e Rrethit Delvinë, gjatë kohës që funksiononte, i shërbente një komuniteti relativisht të vogël, e bën edhe më të mprehtë kujdesin për perceptimin e publikut ndaj ngjarjeve që shihen në kontekstin e funksionimit të një drejtësie të anshme.

*iii) Lidhur me pasurinë shtëpi banimi në ish-objektin “{***}” Sarandë, me sipërfaqe objekti 48,9 m², kati parë i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {***}, faqe {***}, nr. {***} indeksi, datë 21.4.1996 dhe iii/1) pasurinë shtesë kati, e ndërtuar mbi banesën ekzistuese, e përshkruar në pikën iii), me sipërfaqe 110 m², pjesë e së njëjtës ndërtesë [godina nr. {***}] në Sarandë.*

29. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit se ka bërë deklaram të rremë dhe të pamjaftueshëm si dhe atë “vetting” në lidhje me sipërfaqen e apartamentit të tij, tek {***} në deklaratat periodike të pasurisë; se ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke zgjeruar sipërfaqen e banimit përtej lejes së ndërtimit të dhënë nga organi kompetent; se ka ushtruar funksionin e tij si kryetar gjykate në kushtet e konfliktit të interesit; si dhe ka kryer fshehje të pasurisë prej 61,1 m². Subjekti i rivlerësimit argumenton se pasuria është fituar në vitin 1995, kohë në të cilën nuk e ushtronte funksionin e gjyqtarit. Shtesa e katit ka përfunduar pas përshtatjes në vitin 2004 dhe është formalizuar në një të vetme me vendimin gjyqësor. Dokumentacioni i paraqitur për këtë pasuri është i plotë. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim pretendime për secilin prej konstatimeve të Komisionit⁴⁸ si të pambështetura në kuadrin ligjor dhe në provat e administruara dhe kërkon ndryshimin e secilit prej tyre dhe pranimin e deklarameve të tij të sakta, korrekte dhe të mbështetura në ligj dhe në prova.
30. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e Komisionit për këtë pasuri, nga aktet e administruara rezultojnë hapat e mëposhtëm, të renditur në mënyrë kronologjike për qartësi leximi.
- Më datë 14.02.1995, subjekti i rivlerësimit ka blerë në bashkëpronësi me 9 persona të tjerë (10 bashkëpronarë gjithsej) katin e dytë të objektit [{***}] dhe sipërfaqen e truallit nën objekt dhe në funksion të tij, gjithsej 451,5⁴⁹ m².

⁴⁷ Ligji nr. 6341/1981.

⁴⁸ Shih faqe 15- 16 të vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendim-Alltun-Cela.pdf> dhe përmbledhjen për këtë shkak ankimi në paragrafët 4.1.(v) - (viii).

⁴⁹ Më herët kjo pasuri i është shitur nga {***} Sarandë 5 individëve, më datë 02.02.1995. Sipas kësaj kontrate, objekti është dy kate dhe është dorëzuar te blerësit më datë 16.12.1994. Blerësit kanë blerë në bashkëpronësi

- Më datë 29.12.1995, subjekti i rivlerësimit së bashku me 9 bashkëpronarët e tjerë kanë disponuar me kontratën e pjesëtimit⁵⁰. Subjektit të rivlerësimit i ka takuar pjesa prej 48,9 m² e objektit. Me vërtetimin e datës 03.06.1998 të Hipotekës së Sarandës, kjo pasuri deklarohet e regjistruar në librin nr. {***} të pasurive të paluajtshme. Sipas planimetrisë, rezultojnë 10 ndarje apartamentesh dhe sipërfaqja e çdo apartamenti nuk përfshin ballkonet, muret e jashtme dhe muret 20 cm që ndajnë apartamentet.
- Më datë 30.09.1999, ZVRPP Sarandë ka lëshuar vërtetimin se ka të regjistruar në hipotekë në librin nr. {***}, faqe {***}, viti 1995, me nr. indeksi {***}, datë 10.08.1995, pronën me emërtimin “{***}” ku janë shënuar të dhënat e pesë (5) shitësve, të dhjetë (10) blerësve dhe të vendndodhjes dhe sipërfaqes së objektit të shitur, përfshirë edhe sipërfaqen e truallin nën objekt në funksion të tij, gjithsej 451,5 m².
- Më datë 10.12.2001, subjekti i rivlerësimit me 6 bashkëpronarë kanë rënë dakord që në sipërfaqen e truallit në funksion të objektit ku është e ndërtuar magazina, secili bashkëpronar në përpjesëtim me pjesën takuese të ndarë sipas kontratës së pjesëtimit, të ndërtojë një ndërtesë, e cila do të lidhet me banesat ekzistuese dhe që do të jetë në funksion të banesave ekzistuese, që do të shërbejë edhe për rikonstruksionin total të banesës, si: mure ndarëse, vendosje çatie mbi objektin e rikonstruktuar etj.
- Subjekti i rivlerësimit së bashku me 6 bashkëpronarë të tjerë kanë bërë kërkesë (pa datë) për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit, me specifikimin “Rikonstruksion banese ekzistuese”.
- Me kontratën e ndërtimit, datë 10.04.2002, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e investitorit dhe si përfaqësues i bashkëpronarëve, ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion banese”⁵¹.
- Me vendimin nr. {***}, datë 18.04.2002, KRRT ka miratuar lejen e ndërtimit për rikonstruksion banese. Sipas këtij dokumenti, objekti finanohet nga banorët, përfaqësuar nga Alltun Çela. Leja është dhënë me disa kushte, ndër të cilat edhe që destinacioni i sheshit të ndërtimit të jetë për rikonstruksion banese (kushti nr. 1)⁵².
- Më datë 05.07.2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, është regjistruar padia e M. Ç dhe Alltun Çelës, me objekt “detyrimin e palës së paditur, Bashkia Sarandë, për t’i njohur paditësit pronarë me parashkrim fitues mbi një objekt shtëpi banimi dykatëshe të rikonstruktuar, me sipërfaqe ndërtimi dhe trualli 110 m² në lagjen nr. {***}, Sarandë, e regjistruar më datë 21.04.1998 dhe detyrimin e ZRPP Sarandë për të kryer regjistrimin e kësaj pasurie, objektit dykatësh, me sipërfaqe ndërtimi dhe trualli 110 m²”. Në përfundim, pasi ka pranuar padinë, gjykata me vendimin e datës 25.07.2013 ka urdhëruar Bashkinë Sarandë t’u njohë paditësve pronësinë me parashkrim fitues mbi objektin me detajet si më sipër dhe ka urdhëruar ZVRPP-në Sarandë ta pasqyrojë këtë fitim të pronësisë në regjistrin e pasurisë dhe ta regjistrojë objektin në emër të paditësve.
- Më datë 22.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë ZVRPP-së Sarandë kërkesën [nr. {***}] për regjistrim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë [nr. {***} ({***})], datë 25.07.2013.
- Më datë 05.05.2017, ZVRPP Sarandë ka lëshuar certifikatën për vërtetimin e pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, për pasurinë “apartament” me

objektin dhe truallin që zë objekti, gjithsej 903 m². Të njëjtët individë, më pas ia kanë shitur pronën subjektit të rivlerësimit dhe nëntë (9) blerësve të tjerë me kontratën e datës 14.02.1995.

⁵⁰ Dokumentuar me aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol.

⁵¹ Dokumentacion i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe i administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵² Në tekstin e lejes konstatohen shënime dore mbi vitet, të cilat janë të paqarta. Sipas shkresës së Seksionit të Urbanistikës, Bashkia Sarandë, data e lejes së ndërtimit është 18.04.2002.

sipërfaqe 110 m². Në kartelën shoqëruese, pasqyrohet: “[...] sipërfaqe trualli 110 m², banesë 2-katëshe, me sipërfaqe ndërtimi dhe trualli 110 m² për kat [...]”⁵³.

31. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarin e kësaj pasurie ndër vite apo gjatë procesit të rivlerësimit, pasi nga analiza e rrjedhës kronologjike kohore të veprimeve kundrejt deklarinëve të subjektit të rivlerësimit, rezultojnë situata të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur t’i shpjegojë dhe justifikojë bindshëm para Komisionit apo në ankim. Më poshtë, për lehtësi reference, deklarinët e subjektit të rivlerësimit ndër vite dhe në procesin e rivlerësimit për sa i përket kësaj pasurie:
- Në deklarinën e parë të pasurisë, dorëzuar më datë 15.03.2004 [për vitin 2003], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se sipërfaqja e kësaj pasurie (apartament banimi ndërtuar përpara 1990-ës) është 48,9 m², me vlerë 100.000 lekë (0,1 milion lekë).
 - Në deklarinën e interesave privatë për vitin 2004, dorëzuar më datë 15.03.2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë mbi banesën ekzistuese, me leje ndërtimi të datës 06.11.2002, në proces regjistrimi, me sipërfaqe 65 m². Në rubrikën e vitit të krijimit ka deklaruar: “viti 2002 e në vazhdim”. Vlera e shtesës është deklaruar 600.000 lekë. Sipërfaqja e shtesës së deklaruar nuk përkon me sipërfaqen totale të sipërfaqes së shtuar sipas certifikatës së vërtetimit të pronësisë (shih paragrafin 30) edhe as me sipërfaqen e shtesës së katit të dytë apo me shtesën e katit të tretë të godinës – shtuar 61,1 m² në njërin kat dhe 110 m² kati tjetër. Subjekti i rivlerësimit pretendon për gabim në shkrim të kësaj sipërfaqeje në 65 m². Nga aktet e administruara, nuk rezulton që të ketë kërkuar korrigjimin e gabimit të pretenduar apo të ketë kryer korrigjimin në deklarinën e radhës për vitin 2005. Rezulton se në asnjë nga deklarinët ndër vite, subjekti nuk ka shpjeguar saktësisht sipërfaqen dhe veprimet e ndërmarra prej tij për regjistrimin e pasurisë në momentin kur ato janë ndërmarrë.
 - Në deklarinën e interesave privatë për vitin 2005, dorëzuar më datë 15.03.2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asgjë lidhur me këtë pasuri.
 - Në deklarinën e interesave privatë për vitin 2013, dorëzuar në datën 12.03.2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asgjë lidhur me veprimet e kryera për regjistrimin e padisë në gjykatë, aktin e njohjes së pronësisë (vendimi i gjykatës) dhe kërkesën e depozituar në ZVRPP Sarandë për regjistrimin e vendimit të gjykatës⁵⁴.
 - Në deklarinën e interesave privatë për vitin 2015, dorëzuar në datën 16.05.2016, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në vazhdim të deklarinës të bërë në vitin 2004, për ndërtimin e shtesës dhe rikonstruksionit të banesës ekzistuese, për shkak se leja e ndërtimit ishte dhënë në emrin e tij për të gjithë bashkëpronarët, për efekt të regjistrimit në regjistrat e pasurive, i është drejtuar gjykatës, e cila me vendimin gjyqësor [nr. {***}] të datës 25.07.2013, ka njohur fitimin e pronësisë me parashkrimin fitues dhe shtesën e katit të ndërtuar mbi banesën ekzistuese. Në të njëjtin dokument, subjekti i rivlerësimit deklaroi më tej se banesa është regjistruar në regjistrin hipotekor më datë 21.04.1998, kurse vendimi gjyqësor është ende në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së Sarandë. Subjekti nuk deklaroi asnjë shpenzim mbi banesën pas deklarinës nga viti 2002 deri më 31.12.2015, dhe nuk ka deklaruar asnjë vlerë financiare për atë vit për këtë pasuri.
 - Në deklarinën e pasurisë [vetting, dorëzuar në datën 26.01.2017], subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me dy numërtime (3 dhe 4), si vijon: shtëpi banimi me sip. 48,9 m² përshtatur për banim në vitin 1994 – 1995 dhe shtesë e katit me sipërfaqe 110 m². Sa i përket të parës, burim krijimi deklarohet kontrata e shitblerjes datë 14.02.1995, me çmim

⁵³ Shkresa nr. {***} prot., datë 31.10.2018, e ZVRPP-së Sarandë, me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

⁵⁴ Në datën 26.02.2015, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklarinën e interesave privatë për vitin 2014, në të cilën përsëri nuk ka deklaruar asgjë lidhur me vendimin e gjykatës të vitit 2013 dhe me aplikimin e tij, pothuajse 3 muaj pas shpalljes së vendimit gjyqësor, në ZVRPP-në Sarandë.

blerjeje 1.107.000 lekë, në bashkëpronësi në 1/10 pjesë dhe me sipërfaqe në bashkëpronësi 903 m². E dyta ka burim krijimi lejen e ndërtimit, rikonstruksion banese të dhënë me vendim KRRT-së Bashkisë Sarandë, datë 18.04.2002, për 8-bashkëpronarët e objektit. Për shtesën e katit, shpenzimet e kryera në vitin 2002, sipas preventivit dhe lejes së ndërtimit, në vlerën 845.510 lekë, për secilin nga 8 bashkëpronarët. Shpenzimet brenda shtesës së katit, në vitin 2004, sipas preventivit, 595.400 lekë⁵⁵. Subjekti shpjegon edhe: “[...] Me vendimin gjyqësor, datë 25.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është njohur shtesa e katit të ndërtuar mbi banesën ekzistuese pas rikonstruksionit për efekt regjistrimi dhe që është në proces regjistrimi pranë ZRPP Sarandë.” Si vlerë e pasurisë në total deklarohet 1.561.610 lekë (1.107.000 lekë shtëpia e banimit + 1.440.910 lekë shtesa e katit).

- Në përgjigjet e datës 06.11.2018 ndaj pyetësorit të datës 31.10.2018, subjekti i rivlerësimit shprehet se në kohën e blerjes, sipërfaqja e blerë ka qenë 27,50 m² ballkon + 48,9 m² ndërtim + 33,6 m² truall para hyrjes. Sipërfaqja e përgjithshme e shtëpisë që zotëron dhe përdor është 271 m² dhe përfshin: katin përdhe me sipërfaqe ndërtimi 51 m², katin e parë me sipërfaqe të përgjithshme 110 m², nga e cila 48,9 m² sipërfaqe ndërtimi. Pjesa tjetër, prej 61,1 m², është krijuar pas rikonstruksionit. Kati i dytë me sipërfaqe të përgjithshme 110 m², nga e cila 75 m² sipërfaqe ndërtimi dhe 35 m² shkallët dhe ballkonet.

31.1. Për sa është pasqyruar më sipër, nën dritën e dokumentacionit të administruar në fashikull, përfshirë shkresën e ZVRPP-së Sarandë që konfirmon sipërfaqen e kësaj prone të jetë 220 m², trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit përgjatë gjithë periudhës së deklarimit nuk ka qenë i saktë dhe i sigurtë qoftë në deklarimin e sipërfaqes së disponuar prej tij si banesë, qoftë në vlerën e shpenzuar për këtë pasuri, por edhe në veprimet e shumta të ndërmarra për ndërtimin e saj dhe me regjistrimin me vendim gjyqësor, që ka disponuar përtej asaj çfarë diktonte leja e dhënë për rikonstruksionin e banesës ekzistuese. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit qëllimisht e pasqyron shtesën e katit si kat të dytë, ndërkohë që referuar kontratës fillestare të blerjes të datës 14.02.1995, si një ndër bashkëpronarët, ai ka blerë katin e dytë të godinës {***} mbi të cilën ka ndërtuar shtesën e katit, çka përbën katin e tretë të godinës tek {***}. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë lidhur me sipërfaqen e banimit të deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë dhe, për rrjedhojë, të pamjaftueshëm për këtë pasuri, çka ndikon në mosarritje të një niveli të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe ligj.

31.2. Në mënyrë të përmbledhur për çdo pretendim të subjektit të rivlerësimit që lidhet me konstatimet e Komisionit për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vëren sa më poshtë vijon.

31.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit mbi paqartësinë në shpjegimet e tij për shpenzime të kryera për përshtatjen e ambientit për banim në vitin 1994 – 1995 që daton formalisht përpara se ai të fitonte pronësinë. Ai argumenton se pasuria është ndarë dhe është marrë në pronësi dhe në posedim që në datën 14.02.1995 [data e blerjes] dhe pjesët takuese janë formalizuar në kontratën e pjesëtimit të datës 29.12.1995. Nga kontrata e shitblerjes e datës 14.02.1995, konstatohet se dorëzimi i objektit është bërë përpara redaktimit të saj, ndërkohë që vetë shitësit janë bërë pronarë të objektit me kontratën e datës 02.02.1995. Objekti u është dorëzuar vetë shitësve nga pronari fillestar, {***} Sarandë, më datë 16.12.1994. Për rrjedhojë, deklarimi i subjektit se kjo pasuri është përshtatur për banim në

⁵⁵ Sipas deklarimit, shpenzimet e kryera për ndërtimin e shtesës në vitin 2002 dhe ato të kryera në vitin 2004 janë mbuluar nga lekët e dhëna nga prindërit, sipas prokurës së posaçme të datës 18.08.2000, dhe nga kursimet e këtyre viteve.

vitin 1994 – 1995 paraqet vështirësi të kuptohet pasi nëse pranohet, nënkupton që subjekti i rivlerësimit ka zënë dhe përshtatur për banim një pronë publike përpara se kjo e fundit të privatizohet. Nga dokumentacioni rezulton që deri më datë 16.12.1994, objekti ka qenë ende në posedim të {***} dhe deri më datë 02.02.1995 ka qenë edhe zyrtarisht në pronësi publike.

31.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimet e Komisionit lidhur me mospërputhjet në deklaratimet e tij të viteve 2003, 2004 dhe në përgjigjet e pyetësorit të datës 06.11.2018 me deklaratën *vetting*, për sa i përket sipërfaqes së shtëpisë në Sarandë. Sipas tij, Komisioni nuk ka pasqyruar të gjitha shpjegimet, nuk janë marrë në konsideratë të gjitha provat e paraqitura prej tij, dhe ka anashkaluar deklaratimet e tij në pikat 3 dhe 4 të deklaratës *vetting* dhe dokumentacionin bashkëlidhur kësaj deklarate. Subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk e ka fshehur këtë pasuri, pasi e ka deklaruar se ku ndodhet, nuk është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë, ka referuar sipërfaqen për të cilën kishte dokumentacion që ndër të tjera provonte se prona ishte më e madhe se vërtetimi hipotekor. Në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur dokumente shtesë që vërtetojnë se kur është dorëzuar deklarata *vetting*, nuk ka pasur certifikatë pronësie. Këtë të fundit e ka dorëzuar në përgjigje të pyetësorit të Komisionit. Sipas subjektit të rivlerësimit, pavarësisht lapsusit në sipërfaqen e deklaruar në vitin 2004, dokumentacioni shoqërues përcakton qartë sipërfaqen prej 110 m², e cila përkon me deklarinimin e kryer në vitin 2015, kur është formalizuar pronësia me vendim gjykate.

31.5.i. Nga analiza e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, shtjelluar më sipër dhe me fokus deklaratimet e tij në vite dhe gjatë procesit [paragrafi 31] kundrejt dokumentacionit të administruar, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë për vitet 2013 dhe 2014 vendimin e datës 25.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe kërkesën e datës 22.10.2013 drejtuar ZVRPP-së Sarandë për regjistrimin e këtij vendimi që i njihte pronësinë mbi një banesë dykatëshe me sipërfaqe ndërtimore 110 m² dhe truall 110 m². Për herë të parë, ky deklarim është kryer në deklaratën e interesave për vitin 2015. Pavarësisht se certifikata e pronësisë ka dalë më datë 05.05.2017, që domethënë rreth 3 muaj pasi subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë [*vetting*], subjekti i rivlerësimit kishte dijeni dhe pritshmëri që sipërfaqja e banesës që do të regjistrohej nga ZVRPP Sarandë ishte ajo që kishte disponuar gjykata në vendimin e datës 25.07.2013. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk jep shpjegime se përse zgjodhi të mos e korrigjojë sipërfaqen e deklaruar gabim në deklaratën e interesave privatë për vitin 2004 dhe në deklaratat e interesave privatë për vitet pasuese, duke lënë shtesën prej 65 m². Sqarime për sipërfaqen reale në posedim nuk janë kryer as në deklaratën e pasurisë për vitin 2013, pas nxjerrjes së vendimit të gjykatës të datës 25.07.2013, i cili përcaktonte sipërfaqen që i njihej subjektit të rivlerësimit me vendim gjykate dhe urdhëronte ZVRPP-në të bënte regjistrimin për sipërfaqen 110 m² për çdo kat, në total 220 m². Më tej, të dhënat e sipërfaqes së njohur si pronar dhe të urdhëruar për regjistrim me këtë vendim të gjykatës, që është disponuar me padi të ngritur prej tij dhe bashkëshortes, subjekti nuk i ka pasqyruar as në deklaratën *vetting*. Në këtë të fundit, subjekti ka deklaruar vetëm sipërfaqen 48,9 m² dhe shtesën e katit 110 m², që përbën vetëm një pjesë të sipërfaqes në pronësi.

31.5.ii. Kjo qasje evazive e subjektit rezulton të ketë vazhduar edhe gjatë hetimit administrativ. Konkretisht, në pyetësorin e datës 31.10.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë se në kohën që është blerë objekti, sipërfaqja që ai ka blerë ka qenë 27,50 m² ballkon + 48,9 m² ndërtim + 33,6 m² truall para hyrjes. Ky shpjegim bie ndesh me kontratën e blerjes dhe atë të pjesëtimit. Përkundrazi, sipas planimetrisë shoqëruese të kontratës së pjesëtimit, rezulton se në sipërfaqen takuese prej 48,9 m², nuk përfshihet sipërfaqja e ballkoneve, muret e jashtme dhe muret 20 cm që ndajnë apartamentet, por nuk ka asnjë përcaktim lidhur me sipërfaqen e ballkonit dhe të truallit para hyrjes. Së fundmi, asnjë nga këto të dhëna të detajuara nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2003, kur subjekti kishte

kryer punimet e objektit. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si rrjedhojë se pretendimet e subjektit janë të pabazuara dhe kontradiktore. Vlerësimi i Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të sipërfaqes së banimit në deklaramin e viteve 2003 dhe 2004 dhe konkluzioni se ka kryer deklaram të rremë në deklaramtën *vetting*, duke e deklaruar këtë pasuri me sipërfaqe 48,9 m², ndërkohë që sipërfaqja reale është 110 m² ose 220 m² në total, është i saktë.

31.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimet e Komisionit se ai ka vepruar në kundërshtim me lejen e ndërtimit dhënë për rikonstruksion banese, duke ndërtuar kat shtesë. Ai argumenton se ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”. Në bazë të këtij ligji, KRRT e Bashkisë Sarandë ka pasur për kompetencë lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe jo të rikonstruksionit. Pavarësisht nga pasaktësitë në shkrim, leja e ndërtimit është miratuar më datë 18.04.2002, mbi një projekt teknik të detajuar, ku përcaktohen dy (2) kate mbi tokë dhe një (1) kat nën nivelin e tokës. Zërat e situacionit të punimeve tregojnë se gjendet në kushtet e ndërtimit dhe përmirësimit të pjesëve që preken nga ndërtimi dhe ndërhyrjet në një objekt të vjetër. Komisioni ka tejkaluar tagrat e tij kur shprehet në vendim se leja e ndërtimit është korrigjuar me shkrim dore, apo se janë kryer punime përtej lejes së dhënë. Nëse do të kishte tejkalim të volumeve të ndërtimit, do të aplikoheshin masa administrative, deri në prishjen e ndërtimit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar dhe pasqyruar çfarë shkruhej në lejen e ndërtimit. Vendimi i gjykatës nuk ka qenë për të formalizuar një ndërtim të paligjshëm, por për të mundësuar regjistrimin pranë ZVRPP-së Sarandë të pjesës së tij që ishte e përfunduar dhe mbahej peng nga mospërfundimi i punimeve të banorëve të tjerë të objektit. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë projektin për rikonstruksionin e banesës së depozituar me deklaramtën *vetting* dhe as kërkesën e tij për verifikim në vend të këtyre pretendimeve.

31.6.i. Në analizë të dokumentacionit në fashikull kundrejt pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Kërkesa, kontrata e ndërtimit, leja e ndërtimit dhe procesverbali i mbledhjes së KRRT-së, të riprodhuara më poshtë për lehtësi leximi, provojnë se subjekti i rivlerësimit ka përfutuar leje për rikonstruksionin e banesës ekzistuese, por jo për shtesë kati.

i) Kërkesa për miratimin e lejes së ndërtimit – me objekt “Rikonstruksion banese ekzistuese”.

ii) Qëllimi i dhënies së lejes së ndërtimit – “Leje ndërtimi për rikonstruksion banese përf. Alltun Çela”.

iii) Kushtet mbi të cilat jepet leja e ndërtimit. Kushti nr. 1 specifikon: “[...] Të respektohet destinacioni i sheshit për ndërtimin e objektit *rikonstruksion* banese dhe kondicionet urbanistike të dhëna në vendimin e KRRT [...]” Vlen të theksohet se subjekti i rivlerësimit në ankim ka zgjedhur të anashkalojë referencën apo analizën e kushtit nr. 1, duke përzgjedhur t’u referohet vetëm kushteve nr. 2, 3 dhe 5, të gjithave me natyrë të përgjithshme.

iv) Procesverbali i mbledhjes së KRRT-së, datë 18.04.2002, ku me numër rendor {***} pasqyrohet miratimi i *rikonstruksionit* të banesës, përfaqësues Alltun Çela.

v) Kontrata e ndërtimit e lidhur nga subjekti më datë 10.04.2002 me shoqërinë ndërtuese {***} ShPK. Kushti i parë saj parashikon: “Shoqëria ndërtuese [...] merr përsipër ndërtimin e objektit *rikonstruksion* banese [...], me vlerë të punimeve 3.000.000 lekë [...]”.

31.6.ii. Nga ana tjetër, dokumentacioni i përcjellë përmban edhe hollësi të tjera mospërputhjes mes kontratës fillestare dhe situacionit të punimeve të hartuar më pas. Sipas situacionit të punimeve për rikonstruksionin e apartamentit, vlera është përlllogaritur në 6764.083 lekë për 8 bashkëpronarë. Kjo vlerë, përlllogaritur vetëm për subjektin e rivlerësimit, sipas këtij dokumenti, është 845510 lekë [1/8 e 6764.083 lekë]. Situacioni i punimeve të brendshme, vetëm për subjektin e rivlerësimit, është përlllogaritur në vlerën

595400 lekë kundrejt 470.000 lekëve, të parashikuar në kontratën e ndërtimit të datës 10.10.2002.

Edhe rritja e vlerës së investimeve kundrejt sa është parashikuar në dokumentacionin që ka shoqëruar dhe paraprirë lejen e ndërtimit, krijon bindjen se leja e miratuar është dhënë për rikonstruksion banese dhe jo për shtesë banese. Ndërsa kontrata e ndërtimit ka parashikuar preventiv shpenzimesh në vlerën 3.000.000 lekë, sipas situacionit të punimeve kjo vlerë ka rezultuar 6.764.083 lekë, duke tejkuluar dyfishin e shpenzimeve. Së fundmi, në krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit ka tejkuluar lejen e ndërtimit, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe faktin që rreth 11 vite pas dhënies së lejes së ndërtimit për *rikonstruksion* banese (viti 2002) apo 9 vite pas përfundimit të punimeve (viti 2004), subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dhe fituar me parashkrim fitues pronësinë e objektit të ndërtuar prej tij, në gjykatën ku ai ushtronte funksionin. Nga ana tjetër, korrigjimet në të dhënat e kërkesës dhe lejes së ndërtimit, nuk mund t'i atribuohen subjektit të rivlerësimit në kushtet kur një pjesë e të dhënave të korrigjuara janë konfirmuar nga vetë institucionet⁵⁶.

31.6.iii. Përkundër sa ka parashtruar subjekti i rivlerësimit lidhur me konstatimet e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se projekti i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit që mban vulën e Bashkisë Sarandë⁵⁷, i përket periudhës tetor 2002, që daton rreth 7 muaj pas dhënies së lejes së ndërtimit për rikonstruksionin e banesës së subjektit të rivlerësimit dhe 6 bashkëpronarëve investitorë. Nga dokumentacioni në fjalë, rezulton projeksioni i ndërtesës sipas të cilit njëra pjesë e ndërtesës përmban 3 kate, kurse pjesa tjetër dy kate. Planimetria e privatizimit për seksionin e urbanistikës përmban vetëm të dhënat e godinës në pamje horizontale, me të dhënat: sipërfaqe ndërtimi 626 m² dhe sipërfaqe e përgjithshme 1014 m². Këto të dhëna nuk vërtetojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi respektimin e lejes së ndërtimit.

31.7. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk është shprehur për kërkesën e tij për verifikim në vend të godinës, nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar gjatë hetimit administrativ kërkesë për këqyrje të kësaj pasurie⁵⁸. Në seancën dëgjimore, në përgjigje të pyetjes së relatores mbi paqartësitë që lidheshin me sipërfaqen e pronës, subjekti i rivlerësimit është shprehur: “[...] se po të vish në fakt ta shikosh në terren, mund të bindesh thjesht me një të parë [...]”. Nga procesverbali, nuk rezulton që subjekti të ketë shprehur kërkesë dhe as që ndonjë nga kërkesat e tij të jetë debatuar nga ai për pranim. E vetmja kërkesë e administruar, është kërkesa e datës 04.01.2019, me objekt marrjen e provave të reja që lidheshin me kriterin e kontrollit të figurës (mosdisponinimi prej tij për pronat në {***)⁵⁹.

- 32.** Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim⁶⁰ se veprimet e tij kanë qenë në përputhje me ligjin nr. 8405/1998, kur i referohet legjisllacionit të kohës së ndërtimit dhe KRRT Sarandë nuk kishte të drejtë të jepte leje *rikonstruksioni*, por vetëm *leje ndërtimi* dhe dokumentacioni i KRRT-së Sarandë përmban gabime referimi nga vetë institucioni. Po ashtu, subjekti

⁵⁶ Shih formularin e Seksionit të Financës, shkresën nr. {***} prot., datë 01.11.2018, të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, bashkëlidhur dokumentacionit, referuar lejes së ndërtimit të datës 18.04.2002.

⁵⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.12.2018, Bashkia Sarandë.

⁵⁸ Në shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është shprehur: “Ju ftoj ta shihni edhe sot fizikisht për të vërtetuar integritetin e deklaramit tim.” – faqe 6 – referuar sqarimeve të dhëna lidhur me rikonstruksionin e banesës në fshatin {***}. Ndërsa në faqen 17 të këtij materiali, është shprehur: “[...] i lutem Komisionit të kryejë verifikimet për të evidentuar në terren se ku ndodhet kjo pronë” – referuar përgjigjes së dhënë nga ZRPP Sarandë me shkresën e datës 07.02.2018 për pasurinë e pasqyruar gabim në emër të subjektit.

⁵⁹ Shih poshtëshënimin nr. 9.

⁶⁰ Faqe 34-36 të ankimit.

parashtron që, meqenëse asnjë nga institucionet përgjegjëse vendore për disiplinimin e ndërtimeve pa leje nuk ka marrë masa sipas ligjeve në fuqi në vitet në fjalë⁶¹, ndërtimi i kryer prej tij [dhe bashkëpronarëve të tjerë] ka qenë i ligjshëm, ndryshe nga dyshimet e ngritura nga Komisioni.

32.1. Nga analiza e kuadrit ligjor mbi të cilin mbështetet subjekti i rivlerësimit në ankim, por edhe ligjeve të tjera të zbatueshme në periudhën në fjalë për sa u përket ndërtimeve pa leje, rezulton se pretendimi i subjektit është i pabazuar. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje edhe që në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit përzgjedh dispozitat ligjore në mënyrë të pjesshme dhe qëllimisht konfuzuese. Kjo, pasi së pari, ligji nr. 8405/1998 parashikon detyrimin për pajisje *me leje ndërtimi* për çdo punim të ri, përfshirë shtesa, ndërtime mbi themele ekzistuese, ndryshime të objekteve që prekin anën e jashtme, si dhe kur bëhen ndërhyrje në konstruksion dhe në qëndrueshmërinë e objektit ekzistues, hapje dhe mbyllje dritarësh, përshtatje në shtimin e vëllimit të objektit në formë shtesash anësore ose ngritje kati shtesë⁶². Në nenin 45, ligji parashikon detyrimin për pajisjen me leje ndërtimi, i cili përbën dokumentacionin e vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi. Kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularit 3 dhe 3/1 – rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe 5 bashkëpronarët e tjerë kanë plotësuar formularin nr. 3. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se neni 20 i të njëjtit ligj nuk i jep tagra KRRT-së Sarandë të japë leje për *rikonstruksion* është haptazi alogjik dhe tregon një qasje që bie ndesh me formimin dhe përvojën e subjektit të rivlerësimit. Dukshëm, neni 48 i ligjit përfshin në konceptin e punimeve që shoqërohet nga dhënia e lejes së ndërtimit çdo lloj punimi, pa u ndalur në përkufizimin e një termi gjuhësor të huazuar, siç është fjala “rikonstruksion”. Së dyti, arsyet përse institucionet kompetente vendore të ngarkuara nga ligjet nr. 9482/2006 dhe nr. 8408/1998, respektivisht seksioni i Urbanistikës pranë Bashkisë Sarandë dhe Policia Ndërtimore Sarandë, nuk kanë vepruar për të disiplinuar këtë ndërtim apo investitorët, ndër të cilët përfshihej edhe kryetari i gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodheshin këto institucione, janë përtej fokusit të procesit të rivlerësimit.

32.2. Në këtë proces çmojmë se vlen të përmenden si fakte të pakontestueshme se në vitin 2013, kur subjekti fitoi pronësinë me vendim gjykate, sipas ligjit nr. 9482/2006, në ndërtimet pa leje përfshiheshin edhe tejkalimet dhe shtesat informale të objekteve të ndërtuara brenda vendbanimeve formale për përdorim vetjak apo për qëllim fitimi⁶³. Së dyti, legjisllacioni në fuqi në vitin 2002 – kur ka përfunduar ndërtimi sipas vendimit të gjykatës – ka parashikuar që objektet e ndërtuara duhet t'i nënshtroheshin kolaudimit teknik-ekonomik nga një/disa kolaudatorë të licencuar, i/të emëruar nga vetë investitori. Kolaudatori duhet të jetë i papërfshirë në asnjë cilësi në projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të objektit që kolaudohet. Së fundmi, leja e shfrytëzimit nga seksioni/zyra i/e urbanistikës lëshohet vetëm pas administrimit të aktit/procesverbalit të kolaudimit dhe në vijim kryhen veprimet e tjera në adresë të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në vendin ku ndodhet objekti⁶⁴.

32.3. Nga vendimi i gjykatës [Sarandë] për njohjen e pronësisë në vitin 2013, rezultojnë të paktën tri probleme esenciale në dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti dhe të pranuar e referuar nga gjykata:

⁶¹ *Subjekti i referohet ligjit nr. 8408/1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.*

⁶² *Shih nenin 48, ligji 8405/1998.*

⁶³ *Shih nenin 3, shkronja “a” e ligjit nr. 9482/2006, i ndryshuar.*

⁶⁴ *Shih nenet 12 dhe 13, në Kreun III të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.*

a) akti i kolaudimit daton dy vjet përpara përfundimit të punimeve, konkretisht 30.10.2000, ndërkohë që sipas vetë kontratës dhe vendimit të gjykatës, ndërtimi duhet të kishte përfunduar në vitin 2002;

b) kolaudatori D. B është edhe përfaqësues i shoqërisë së ndërtimit – cilësi që bie haptazi ndesh me ligjin nr. 8402/1998 (neni 12);

c) akti i kolaudimit sipas ligjit duhet të ndiqte një rrugë institucionale që përfshinte urbanistikën dhe ZRPP-në Sarandë. Akt-kolaudimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës dhe i pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë si provë në vitin 2013, ishte i pacertifikuar nga Bashkia dhe, për pasojë, i papërdorshëm dhe i pavlefshëm nga zyra e regjistrimit të pasurisë. Së fundmi, kjo pasuri, e fituar me këtë vendim gjykate dhe mbi bazën e këtyre dokumenteve, në fakt nuk është regjistruar nga ZVRPP Sarandë deri në vitin 2017.

32.4. Për sa më sipër, duke parë rregullimet ligjore në tërësi, rezulton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk bazohen në ligj dhe në fakte. Përkundrazi, pavarësisht cilësisë së magjistratit të hershëm dhe me detyrë drejtuese, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kërkuar zbatimin me përpikëri të legjislacionit. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur t'i drejtohet gjykatës për të bërë regjistrimin e pasurisë me parashkrim fitues në 2013-ën, pas një harku kohor prej 9 – 11 vitesh nga përfundimi i ndërtimit⁶⁵, për një pasuri të cilën *de facto* dhe më pas *de jure* e ka zgjeruar më shumë se 4-fishin e sipërfaqes së blerë në vitin 1995, krijon bindjen se përzgjedhja e kësaj rruge ligjore për regjistrimin e kësaj pasurie është bërë edhe për shkak të aksesit që subjekti i rivlerësimit kishte në gjykatën në të cilën ai ushtronte edhe detyrën e drejtuesit. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë edhe pasaktësitë dhe paqartësitë që vendimi i gjykatës përmban në pjesën arsyetuese, duke përfshirë edhe bazueshmërinë në një provë të parregullt ligjore, sikurse është akti i kolaudimit, por edhe faktin që subjektet e tjera të interesuara – Bashkia dhe ZVRPP Sarandë – sipas tekstit të vendimit, e kanë lënë në vlerësimin e gjykatës kërkimin e paditësve.

33. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se ai nuk ka vërtetuar me dokument faktin që bashkëpronarë ishin 8 (tetë) individë, në funksion të përpjesëtimit të shpenzimeve të deklaruara për investimin. Ai argumenton se përlllogaritja nga ana e tij është bazuar në preventivin e situacioneve të punimeve, të cilat janë llogaritur për 8 investitorë. Subjekti pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për këto shpenzime, gjë që duhet ta analizonte Komisioni për vitin e deklarimit në lidhje me diferencën e shpenzimeve të kryera atë vit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga dokumentacioni në fashikull rezulton se aneks kontratën e kanë nënshkruar shtatë (7) bashkëpronarë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Kërkesa për lejen e ndërtimit, projekt konstruksioni dhe situacioni i punimeve pasqyrojnë gjashtë (6) bashkëpronarë. Në situacionin e punimeve që shoqëron këtë dokument rezultojnë emrat e 6 bashkëpronarëve në cilësinë e investitorëve për vlerën e punimeve në shumën 6.764.083 lekë. Vetëm në një nga situacionet e punimeve është përlllogaritur vlera 845.510 lekë për 1/8 pjesë. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte që vërtetojnë vlerën reale që ai i ka paguar firmës së ndërtimit për pjesën tij, sikurse mund të jenë mandatpagesat apo dokumente bankare për kalimin e shumës së paguar firmës së ndërtimit. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai ka paguar 1/8 e vlerës së punimeve mbetet në nivel deklarativ, pasi bie ndesh me shumicën e akteve të paraqitura që dëshmojnë për 6 ose 7 investitorë. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit

⁶⁵ Në deklaratën “vetting” subjekti i rivlerësimit deklaroi shpenzime në vitin 2004 për punime brenda shtesës së katit; në deklaratën e interesave privatë për vitin 2004 e deklaroi pasurinë të krijuar në vitin 2002 e vazhdim; në ankim [shih faqen 55] e deklaroi të përfunduar shtesën e katit në vitin 2004, ndërsa në vendimin e gjykatës është deklaruar përfundimi i rikonstruksionit në vitin 2002.

vlerëson se për të vërtetuar mjaftueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, ishte e domosdoshme që Komisioni të kryente analizë financiare të të ardhurave të ligjshme të deklaruara dhe të vërtetuara me dokumentacion ligjor, kundrejt shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni duhet të analizonte deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me një analizë të detajuar financiare, duke e përlogaritur vlerën sipas të gjitha varianteve, për të vlerësuar nëse subjekti kishte mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme – 1/6 e shpenzimeve – në vlerën 1.127.347,7 lekë – apo 1/7 e shpenzimeve në vlerën 966.297,57 lekë – dhe të vërtetonte në këtë mënyrë nëse deklarimi i pjesës që është e barasvlershme me 1/8 është bërë me qëllim mbulimin e shpenzimeve me burime të ligjshme të të ardhurave. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se investimi i tij është vetëm 1/8 pjesë e investimit, mbetet i paprovuar dhe i pavërtetuar.

34. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se paraqitja e padisë me objekt fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka përbërë veprim në kushtet e konfliktit të interesit, me argumentin se vendimi ka marrë formë të prerë dhe nuk është cenuar asnjë e drejtë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni e ka vendosur atë vetë në pozita diskriminuese kur shprehet se praktika e para vitit 2013 dhe ajo pas vitit 2018 janë korrekte, ndërsa ai është në konflikt interesi. Subjekti pretendon se ka ushtruar të drejtën e tij përpara një gjykate të pavarur dhe se nuk ka dëshmuar asnjë rast trajtimi preferencial prej tij, gjatë detyrës si kryetar i gjykatës, për gjyqtarin që ka shqyrtuar padinë e ngritur nga subjekti.

34.1. Në vijim të arsytimit në paragrafin 28.ii.7, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Kodi i Procedurës Civile *nuk* përmban dispozita që parashikojnë si veprohet nëse një gjyqtar bëhet palë në një çështje në gjykatën ku shërben. Dispozitat e kodit rregullojnë përjashtimin⁶⁶ dhe heqjen dorë⁶⁷ të një gjyqtari nga shqyrtimi apo gjykimi i një çështjeje në rrethana të caktuara kur funksioni zyrtar mund të jetë në kontradiktë me interesin privat të anëtarit të trupit gjykues. Paraqitja e një gjyqtari në cilësinë e palës në gjykatën ku ai vetë shërben nuk përbën as rast për përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve dhe as shkas për delegimin e gjyqtarëve nga gjykata të tjera. Në të njëjtën qasje janë edhe përcaktimet e vendimit nr. 319, datë 03.05.2013, të KLD-së “Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore” që parashikon delegimin vetëm për shkak të respektimit të afateve kohore në shqyrtimin e çështjeve për gjykatat, si dhe konkluzionet e diskutimeve të anëtarëve të KLD-së në mbledhjen e datës 11.10.2018⁶⁸. Në këtë të fundit, u vendos të ndiqen vetëm dispozitat procedurale civile, të cilat nuk parashikojnë delegimin në rast se gjyqtari bëhet palë ndërgjyqëse në çështje civile.

⁶⁶ Neni 72 i K.Pr.Civile parashikon se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërit apo tjetrit palë; 5. është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

⁶⁷ Neni 73 i K.Pr.Civile parashikon se gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.

<http://arkiva.klgj.al/vendime/2013/vendim-nr-319,-dat%C3%AB-03-05-2013>
<http://arkiva.klgj.al/procesverbale/2018/kld-2018-10-11.pdf>

34.2. Në analizë të gjithë veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, dhënia e një vendimi gjyqësor për njohje të drejtave të pronësisë me parashkrim fitues brenda 20 ditëve nga paraqitja e padisë nga subjekti, dhe në prani të rrethanave të tjera faktike, siç ishte ndërtimi në kapërcim të lejes së ndërtimit, dokumentacioni që përmbante pasaktësi dhe paqartësi në përmbajtje dhe në shkelje të kriterëve ligjore të parashikuara për ndërtimet – analizuar me hollësi në paragrafin 32 [dhe nënparagrafët pjesë e tij] krijojnë dyshime të arsyeshme mbi vendimin e dhënë nga gjykata. Një situatë e tillë më së shumti ndikon në cenimin e besimit të publikut te drejtësia, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit përfiton në mënyrë të dyshimtë të drejta reale mbi pasuri të paluajtshme nëpërmjet adresimit dhe marrjes së një vendimi në kohë rekord në favor të tij për një pronë, dokumentacioni i ndërtimit dhe kolaudit të së cilës e kishte bërë të pamundur regjistrimin për 11 vjet [2002-2013]. Për rrjedhojë, pavarësisht se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë të konfliktit të interesit qëndron në leximin e shkronjës së ligjit, duke qenë drejtues i gjykatës, subjekti duhet të kishte marrë masa për të shmangur çdo lloj sjelljeje të mundshme, të cilat edhe në dukje cenojnë besimin e publikut.

35. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se ai ka ndërtuar në tokën shtetërore pasi pasuria është krijuar në {***} dhe ndërtimi ka qenë i përmasave 50 m x 25 m. Nga urdhri nr. {***}, datë 05.05.2017, i regjistrueses së ZVRPP-së Sarandë, rezulton se subjekti ka ndërtuar në tokën “me pronar shtet”, pa u shoqëruar me informacion mbi këtë gjendje të konstatuar. Ndërkohë që me shkresën nr. {***} prot., datë 14.12.2018⁶⁹, ZVRPP Sarandë informon se shtëpia e banimit prej dy katesh ndodhet mbi pasurinë {***}{***}. Lidhur me këtë çështje, nuk rezulton që Komisioni të ketë konkluduar në vendim nëse qëndron fakti që subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar në tokë publike. Komisioni ka pasqyruar një fakt në përmbajtjen e urdhrit nr. {***}, që mbeti i paprovuar në përfundim të vlerësimit të çështjes dhe, si i tillë, nuk është pjesë e konkluzioneve për kriterin e pasurisë. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, duke mos pasur bazë në konkluzionet e Komisionit, nuk do të shqyrtohet më tej nga trupi gjykues i Kolegjit.
36. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sa i përket pasurisë së dhënë me qira me sipërfaqe prej 48,9 m² të z. A. B deri në vitin 2015. Subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në deklaratën e pasurisë (*vetting*) nga kjo pasuri për vitet 2010-2015. Komisioni ka konkluduar se nuk është krijuar bindja në vërtetësinë e deklarimeve të viteve 2003 dhe 2004 sa i përket kësaj sipërfaqeje dhe statusit të saj si pasuri e shfrytëzueshme për qiradhënie. Duke e analizuar në raport me deklaramin e kësaj pasurie në tërësi, Komisioni vëren se megjithëse sipërfaqja 48,9 m² është raportuar në vitin 2003, për herë të parë Komisioni është njohur me kartelën e pronësisë vetëm në përgjigje të pyetësorit të datës 06.11.2018 nga subjekti i rivlerësimit. ZVRPP Sarandë nuk i ka përcjellë dokumentacion me përshkrim të veçantë për këtë pronë Komisionit. Subjekti parashtron se ka provuar pronësinë mbi dy kate prej 110 m², sipërfaqja prej 48,9 m² është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 e përfituar me kontratën e shitjes së datës 14.02.1995 dhe sipërfaqja e re e banesës prej 110 m² për çdo kat ka qenë e banueshme që në vitin 2004, por është regjistruar në ZVRPP Sarandë në vitin 2017, pasi ka përfunduar marrëdhënia e qirasë me z. A. B. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk i referohet relacionit teknik të hartuar nga ing. D. B për të vërtetuar shpjegimet e tij.

36.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se deklaramet periodike të subjektit të rivlerësimit janë në kontradiktë me dokumentacionin e administruar. Konkretisht, në deklaratën e interesave privatë për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga kontrata e qirasë me A. B për shtëpi banimi (magazinë), në vlerën 100.000 lekë në muaj, ndërkohë që sipas

⁶⁹ *Shih fashikullin 16, faqe 2045.*

kontratës [nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.03.2010] qiraja rezulton 10000 lekë në muaj, 1/10 e shumës së deklaruar. Kontrata ka pasur për objekt shtëpinë e banimit me sipërfaqe ndërtimore 48,9 m². Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, në vitin 2010 kjo pasuri tashmë përbëhej nga 220 m² (61,1 m² më shumë kati i dytë i objektit dhe 110 m² kati i shtesës së objektit). Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar në deklaratën fillestare për vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting* se sipërfaqja takuese e tij, përveç 48,9 m², përfshinte ballkonin dhe truallin – siç ka deklaruar gjatë procesit të hetimit në pyetësorin e datës 31.10.2018 dhe më pas në shpjegimet e rezultateve të hetimit. Së fundmi, edhe në parashtrimet në ankim, subjekti i rivlerësimit vazhdon të jetë i pasaktë kur i referohet pasurisë së tij/pjesës takuese prej 48,9 m² në katin e parë, ndërkohë që sipas kontratës së datës 14.02.1995, kjo pjesë ka qenë në katin e dytë të {***}.

36.2. Lidhur me pretendimin që Komisioni nuk i referohet relacionit teknik të kryer nga ing. D. B, trupi gjykues i Kolegjit vëren se dokumentacioni në fjalë përmban dy probleme. Së pari, relacioni teknik i referohet një prone me sipërfaqe më të madhe nga sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit, si dhe për faktin se relacioni është hartuar nga përfaqësuesi i firmës së ndërtimit për rikonstruksionin e banesës, që ka kryer edhe punimet e ndërtimit shtesë dhe ka hartuar edhe aktin e kolaudimit të banesës në vitin 2000 (ende pa përfunduar objekti) – në shkelje të legjislacionit që rregullon këtë fushë [shtjelluar më sipër në paragrafët 32 dhe 32.3. Po ashtu, konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri ka ardhur si pasojë e analizës në tërësi të deklaramëve të subjektit kundrejt dokumentacionit të administruar gjatë procesit dhe është përqendruar te deklarimi i rremë për sipërfaqen 61,1 m², e cila nuk kushtëzohet domosdoshmërisht nga shqyrtimi i relacionit të ndërtuesit kolaudator. Për këto arsye, pavarësisht se Komisioni nuk ka analizuar relacionin e ing. D. B kundrejt dokumentacionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në dritën e problemeve të identifikuar më sipër, vendimmarrja e Komisionit lidhur me këtë aspekt, bazuar në analizën e mospërputhjeve të konstatuara në deklaramet e subjektit të rivlerësimit, qëndron.

36.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se në deklaratën *vetting* ka deklaruar shtesë kati të ndërtuar mbi banesën ekzistuese, duke fshehur pjesën prej 61,1 m², ndërkohë që nga dokumentacioni dhe përgjigjet e tij të datës 06.11.2018, rezulton se subjekti ka në total katin e parë dhe të dytë me nga 110 m² secili, pra gjithsej 220 m² [kundrejt 48,9 m² + 110 m²]. Subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni ka shkëputur pjesë të shpjegimeve të tij të nxjerra nga konteksti. Komisioni nuk i referohet deklaramit të tij në deklaratën *vetting* plotësisht dhe as ka pasqyruar të gjitha dokumentet shoqëruese të deklaramit *vetting* (rreth 15 dokumente), si dhe anashkalon deklaramet e kryera në pikat 3 dhe 4 të kësaj deklarate. Sipas subjektit të rivlerësimit, e njëjta trupë e Komisionit e ka vendosur në kushte diskriminimi në raport me subjektet e tjera të gjykuara prej tyre.

36.4. Sikurse u analizua edhe në paragrafët e mësipërm, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë i pasaktë dhe i pavërtetë në deklaramet e tij, pasi deri në vitin 2004 ka shtuar rreth 61,1 m² sipërfaqe në katin e dytë të objektit të {***} dhe 110 m² shtesë si kat të tretë, të cilat fillimisht (në deklaratën e interesave privatë për vitin 2004) dhe në paqartësi të qëllimshme i ka deklaruar si shtesë kati mbi banesën ekzistuese dhe ndërtim, datë 06.11.2002, në proces regjistrimi, sipërfaqe 65 m², ndërkohë që sipërfaqja e shtuar është pothuajse 3 herë më shumë se ajo e deklaruar. Më tej, në korrik të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit u pajis me vendim gjykate për njohje të së drejtës së pronësisë mbi një shtëpi banimi dy kate, sipërfaqe ndërtimore dhe truall në funksion të saj 110 m², të cilin e dërgoi për regjistrim pranë ZVRPP-së Sarandë në tetor të vitit 2013. Në vitin 2016, kur plotësoi deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar atributet e vendimit gjyqësor të datës 25.07.2013, por jo sipërfaqen konkrete të shtuar, për të cilën gjykata ka

urdhëruar ZRPP-në Sarandë për ta regjistruar. Në deklaratën *vetting*, subjekti është shprehur: “shtesë e katit, e ndërtuar mbi banesën ekzistuese, e përshkruar në pikën 3, me sipërfaqe 110 m²”, ndërkohë që në pikën 3, sipërfaqja e banesës ekzistuese është deklaruar 48,9 m². Rreth 22 muaj më vonë, gjatë procesit të hetimit në Komision, në nëntor 2018, subjekti për herë të parë ka deklaruar plotësisht sipërfaqet e dy kateve të shtëpisë së tij. Ndodhur në këtë kontekst faktesh, veprimesh dhe deklarimesh të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pavarësisht pretendimeve të tij, me veprime të dukshme konkludente, ai ka kryer deklarim të rremë të një pasurie të zgjeruar përtej lejes së ndërtimit të dhënë vetëm për *rikonstruksion* banese ekzistuese, sjellje kjo që drejtpërdrejt ndikon në humbjen e besimit të publikut te drejtësia. Ky përfundim bazohet ndër të tjera edhe në dritën e faktit që subjekti i rivlerësimit ka ushtruar për vite me radhë, përfshirë edhe gjatë kohës kur janë konstatuar veprimet e tij në kapërcim të ligjit, detyrën e drejtuesit të një institucioni që duhet të japë drejtësi. Parë në këndvështrimin e një vëzhguesi të pavarur, është e pamundur të argumentohet ruajtja e besimit të publikut te drejtësia, në kushtet kur një magjistrat fiton pronësi përtej sa është disponuar nga organet administrative dhe në shkelje të këtyre disponimeve, në gjykatën që ai vetë drejton.

*iv) Pasuria me përshkrimin “ambient magazinë, ndërtuar para viteve 1990, përshtatur për banim, kati përdhe, poshtë banesës ekzistuese, e përshkruar në pikën iii), me sipërfaqe 51 m², lagjja nr. {***}, Sarandë, regjistruar në zonën kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, volum {***}, faqe {***}, rr. “{***}”, Sarandë”*

37. Subjekti i rivlerësimit kundërshton shprehjen “*mund të jetë korrekt*” në përfundimin e vlerësimit të Komisionit për këtë pasuri, duke pretenduar se ky është përfundim i pasaktë, paragjykes, dashakeqës, që e vendos në kushtet e humbjes së besimit të publikut, dhe kërkon ndryshimin e këtij konstatimi dhe heqjen e fjalës “*mund*”.

37.1. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe një individ tjetër, z. M. N, kanë blerë më datë 17.08.2002 një pasuri me përmasa 11 x 9,5 m². Pas pjesëtimit të rënë dakord më datë 01.09.2002, pjesa që ka në përdorim subjekti i rivlerësimit është e përshtatur për banim, kurse pjesa që ka z. M. N shërben si magazinë. Bashkëpronarët kanë rënë dakord që shpenzimet për përshtatjen e ambientit për banim dhe të ardhurat që do të sigurohen nga dhënia me qira e objektit do të ndahen në masën 50% për secilin. Sipas preventivit të punimeve, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vlera e investuar është 510967 lekë. Sipas deklaratës *vetting*, shpenzimet brenda ambientit janë rreth 255484 lekë (1/2 pjesë e shumës së përcaktuar në preventivin e punimeve prej 510967 lekësh). Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet për përshtatjen e ambientit nga mjedis saldimi në banesë. Pas sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar se shpjegimet e tij *mund* të jenë korrekte. Në situatën e paraqitur, trupi gjykues i Kolegjit nuk vëren se Komisioni është treguar i pasaktë, paragjykes apo dashakeq në vlerësimin e tij. Për më tepër, që ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet i paprovuar me veprime apo qëndrime konkrete, që do të dëshmonin se Komisioni e ka vendosur atë në kushtet e humbjes së besimit të publikut. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon të mos e analizojë këtë pretendim.

*v) Pasuria truall 400 m², parcela nr. {***}, blloku {***}Sarandë*

38. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se ka kryer deklarim të rremë për sipërfaqen e truallit prej 400 m², duke kërkuar që deklarimi të konsiderohet i saktë dhe në përputhje me ligjin. Ai [subjekti i rivlerësimit] e ka deklaruar këtë pasuri për të mos qenë në kushtet e mosdeklarimit. Komisioni ka qenë paragjykes dhe dashakeqës dhe e ka vendosur për ekzistencën e kushteve të humbjes së besimit të publikut tek ai si gjyqtar.

38.1. Nga shqyrtimi akteve, konstatohet se në deklaratën e interesave privatë për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën përkatëse: “sipërfaqe shesh ndërtimi 400 m², Blloku Nr. {***}, parcela nr. {***}, Sarandë, përfituar me vendimin nr. {***}, datë 28.08.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, marrë në dorëzim më datë 15.07.2005”. Prona është deklaruar pa vlerë, pasi shpjegohet se është “në proces, pa kryer blerjen”. Kjo pasuri rezulton e deklaruar edhe në deklaratën *vetting*, ku përveç të dhënave të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pasuria është e papaguar, pa kontratë shitblerjeje dhe e paregjistruar në ZRPP. Sipas dokumentacionit⁷⁰, konfirmohet dhënia e sheshit të ndërtimit me vendimin nr. {***}, datë 28.08.1999, nga Këshilli i Bashkisë Sarandë subjektit të rivlerësimit.

38.2. Kjo pasuri nuk rezulton të jetë në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.12.2018, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë (kthyer përgjigje kërkesës së subjektit të rivlerësimit) informon se procesi i lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe kalimit në pronësi të parcelës ndërtimore, pas vitit 2006, është pezulluar për shkak të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, adresuar Bashkisë Sarandë dhe ZVRPP-së Sarandë. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 31.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në vitin 1997 i ka kërkuar Bashkisë Sarandë shesh ndërtimi për banim. Subjekti shpjegon se nuk ka kërkuar leje ndërtimi dhe nuk ka kryer pagesë për këtë shesh ndërtimi.

38.3. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar sheshin e ndërtimit në deklaratën e pasurisë të interesave privatë të vitit 2005, ndërkohë që vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë që miratonte dhënien e tij i përket vitit 1999, përpara deklaratës së vitit 2003. Megjithatë, është e pakontestueshme që kjo pasuri është deklaruar në vitin 2005 dhe në deklaratën *vetting*. Udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së⁷¹ përcakton se deklarimi i pasurive të paluajtshme të *paregjistruara* në regjistrat publikë duhet të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor. Po kështu, deklarata *vetting*, në rubrikën e deklarimit të pasurisë parashikon se objekti i deklarimit janë: *Të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të pasurisë [...], të cilat ndodhen në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit [...]*. Trupi gjykues i Kolegjit vëren që, pavarësisht se sheshi i ndërtimit nuk rezulton të jetë në pronësi, në posedim dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur ndaj tij është disponuar me vendim miratimi nga Këshilli i Bashkisë Sarandë për disponimin e kësaj pasurie, ai kishte detyrimin e deklarimit, sikurse edhe e ka deklaruar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të rremë dhe vlerësimi i Komisionit është i gabuar. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se Komisioni ka qenë paragjykues dhe dashakeqës duke e vendosur atë në kushtet e humbjes së besimit të publikut.

*vi) Pasuria me përshkrimin “ambient me sipërfaqe 30 m², lagjja nr. {***}, Sarandë, kati dytë, i pamobiluar”*

⁷⁰ *Bashkëlidhur sqarimeve shtesë, datë 08.11.2018, për pyetësorin e datës 06.11.2018, shkresa nr. {***} prot., datë 07.11.2018, e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës” drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.*

⁷¹ *“Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pika 8 e udhëzimit parashikon: “[...] 8. Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerjeje, kontratë sipërmarrjeje, aktmarrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj. dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP [...]”.*

39. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit, duke cenuar etikën dhe figurën e gjyqtarit duke e vendosur në pozita diskriminuese dhe të pafavorshme, në shkelje të nenit 18 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, pasi lidhur me konfliktin e interesit, i njëjti trup gjykues ka mbajtur standarde të ndryshme për subjekte të ndryshme (si në rastin e vendimit nr. 26/2018 dhe nr. 53/2018⁷²). Vendimi gjyqësor nr. {***}, i dhënë prej tij (si gjyqtar i vetëm) është vendim pushimi për shkak të mosparaqitjes së palëve. Ky vendim është dhënë përpara nënshkrimit të kontratës me sipërmarrësin Ç. Z (viti 2011) dhe ndërtesa ku ai ka blerë ambientin prej 30 m² nuk ka lidhje me objektin e çështjes; nuk ka përfituar çmim preferencial; ka vërtetuar se ka shlyer të plotë pagesën me burime të ligjshme financiare.

39.1. Nga analiza e akteve të administruara dhe e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se gjendja e konfliktit të interesit ndërmjet ushtrimit të detyrës dhe interesit personal, në rrethanat e faktit në fjalë, nuk vërtetohet. Marrëdhënia e interesit që mund të ndikonte në ushtrimin e detyrës është e mëvonshme. Konkretisht, rezulton se më datë 26.07.2010, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes me palë paditëse S. B dhe me palë të paditur Ç. Z, me objekt shpalljen e pavlefshmërisë absolute të një kontrate të shitblerjes të datës 01.03.2006 mes palëve ndërgjyqëse. Më datë 31.03.2011, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositesit, ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me investitorët {***}⁷³ për ndërtimin e një lokali shërbimi (zyrë) me sipërfaqe 30 m², me çmim 1.200.000 lekë. Pagesa është shlyer plotësisht sipas deklaratës së z. G. Z, të datës 27.12.2016⁷⁴. Marrëdhënia kontraktore mes subjektit dhe të paditurit, z. Z., rezulton të ketë ndodhur 10 muaj pas pushimit të shqyrtimit të çështjes.

39.2. Referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. Duke pasur parasysh kronologjinë e mësipërme, ekzistenca e ndonjë interesi të mundshëm pasuror mes subjektit të rivlerësimit dhe investitorëve Z., përfshirë edhe z. Ç. Z, nuk provohet. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit, duke cenuar etikën dhe figurën e gjyqtarit, nuk qëndron.

39.3. Nga ana tjetër, kushtëzimi i papapajtueshmërisë apo marrjes së një vendimi në kushtet e konfliktit të interesit me llojin e shqyrtimit gjyqësor apo fazës së gjykimit, siç argumenton subjekti i rivlerësimit në rastin konkret, është i pabazuar në ligj. Ekzistenca e konfliktit të interesit nuk kushtëzohet nga lloji i vendimmarrjes.

39.4. Më tej, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pambështetura edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të dispozitave kushtetuese dhe të KEDNj-së për shkak të aplikimit të standardeve të dyfishta për gjendjen e konfliktit të interesit, duke e vendosur atë në pozita diskriminuese dhe të pafavorshme. Subjekti i rivlerësimit e ilustron pretendimin e tij për diskriminim, bazuar në qëndrime të ndryshme të një anëtareje të trupit gjykues, në një

⁷² Shih:

<https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/07/vendim-Ilir-Toska.pdf>

<https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendimi-A.-Broci-i-azhornuar.pdf>

⁷³ Kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 31.03.2011.

⁷⁴ Me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 27.12.2016, deklaruesi G. Z ka deklaruar se porositesi e ka likuiduar tërësisht pagesën e shitjes së ambientit të cilin ndërtuesi e ka dorëzuar të përfunduar.

mendim pakice⁷⁵. Sikurse është arsyetuar në paragrafët 18 dhe 23 të vendimit, nuk rezultojnë të dhëna apo indicie që Komisioni të ketë marrë vendim bazuar në ndonjë element që lidhet personalisht me vetë subjektin e rivlerësimit, duke çuar në vendimmarrje të diferencuar. Nga ana tjetër, qëndrimi i një anëtari të trupës gjyqësore, i shprehur me mendim pakice në një vendim të caktuar, nuk mund të përbëjë argument për të pretenduar zbatim të standardeve të dyfishta apo të dyshimeve për diskriminim. Për më tepër, vendimi nr. 53, datë 31.07.2018, i Komisionit, të cilit i referohet subjekti i rivlerësimit në ankim, i është nënshtruar juridiksionit rishikues të Kolegjit, i cili ka mbajtur qëndrim lidhur me çështjen e konfliktit të interesit⁷⁶.

40. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pavërtetë konstatimin e Komisionit se në cilësinë e kryetarit të gjykatës nuk ka marrë asnjë masë për pasqyrimin me vërtetësi dhe transparencë të të dhënave të çështjeve gjyqësore në faqen zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Ky konstatim nuk ka lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Administrimi i sistemit nuk është detyrë funksionale e tij; nuk ka pasur ankesa lidhur me aksesin në të dhënat e gjykatës.

40.1. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se në faqen elektronike të gjykatës rezultojnë 8 çështje ku emri i subjektit të rivlerësimit pasqyrohet si “A. Ç”. Këto vendime u përkasin viteve 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2018. Sipas përgjigjes së dhënë nga Shoqëria {***}⁷⁷, logjika e implementuar për marrjen e emrit të gjyqtarit është e gabuar dhe janë sugjeruar veprime teknike për zgjidhjen e situatës. Fakti që gjenerimi i kësaj të dhëne të gabuar ka qenë i shtrirë në kohë, duke filluar nga viti 2012, tregon për një neglizhencë nga ana e punonjësve të gjykatës, për të siguruar saktësinë e të dhënave që gjeneron portali i gjykatës, bazuar në informacionin e ngarkuar në sistem. Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor⁷⁸ lidhur me kompetencat për mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, duhet të kujdesej për mirëfunksionimin administrativ të gjykatës, veçanërisht për çështje që lidhen me transparencën dhe aksesin në të dhënat e gjykatës.

40.2. Trupi gjyqësor i Kolegjit sjell në vëmendje se saktësia e hedhjes së informacionit në sistemin elektronik të gjykatës nuk është aspekt që lidhet me kriterin e vlerësimit të pasurisë në kuptimin të nenit D të Aneksit të Kushtetutës e neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016. Referuar këtyre dispozitave, objekti i kriterit të vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Ky konstatim i Komisionit do të duhej të ishte përfshirë në analizën që lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, dhe konkretisht me aftësitë organizative. Teorikisht, konstatimi i këtij problemi veçmas, vlerësuar në kontekstin e kriterit të vlerësimit profesional, në rrethanat konkrete nuk do të diktonte mjaftueshëm peshë për të konkluduar për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor i Kolegjit e vlerëson të gabuar konsiderimin e kësaj çështjeje nga Komisioni në konkluzionet përfundimtare për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi nuk u përgjigjet asnjë prej situatave që parashikon neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Këto rrethana faktike, edhe në këndvështrim teorik e logjik, nuk përmbushin kërkesat ligjore për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

⁷⁵ Shih faqen 62 të ankimit.

⁷⁶ Shih - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendim-A-Broci-i-anonimizuar-per-publikim-1.pdf>

⁷⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 14.12.2018, e Shoqërisë {***}.

⁷⁸ Shih ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh” (neni 37, shkronja “h” dhe neni 39, pika 2, shkronja “a”), rregulloret e brendshme për administratën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të miratuara nga kryetari i Gjykatës me urdhrat nr. {***}, datë 29.03.2011, dhe nr. {***}, datë 04.07.2014.

41. Në përfundim, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me shkaqet e ankimit për këtë kriter, dhe të konsideruara relevante për zgjidhjen e çështjes, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se edhe sikur të konsideroheshin të drejta të gjitha pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit, nuk do të mund të ndryshonin vlerësimin se ai gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi: i) nuk shpjegoi bindshëm mospërputhjen e sipërfaqes prej 500 m² të pasurisë së paluajtshme të shtëpisë së banimit dhe truallit në fshatin {***}, Delvinë, të përfituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 01.09.1994, me sipërfaqen prej 600 m² të regjistruar me vendimin e datës 12.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Delvinë, dhe ii) ka kryer deklarim të rremë lidhur me sipërfaqen e banimit të deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting* të pasurisë e paluajtshme shtëpi banimi në ish-objektin {***}, Sarandë. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është e drejtë masa disiplinore e marrë nga Komisioni për shkarkimin nga detyra për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
42. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se proceset gjyqësore të zhvilluara për njohjen e pronësisë së këtyre dy pasurive të mësipërme gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e kryetarit të gjykatës, krijojnë premisa për perceptimin nga publiku të një qasjeje që nuk mund të perceptohet pozitivisht nga publiku, situatë që cenon drejtpërdrejt besimin e publikut te drejtësia dhe përcakton vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

43. Subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vlerësimit të DSIK-së dhe të Komisionit, bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, duke vendosur përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, pasi ka nivel të besueshëm në kontrollin e figurës. Ndërsa e ka vlerësuar subjektin të papërshtatshëm për të vazhduar detyrën, DSIK-ja në vlerësim nuk ka treguar kontaktin e papërshtatshëm.

43.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se vlerësimi i figurës nga Komisioni është i papabazuar në fakte dhe prova, është paragjykes, armiqësor, në shkelje të kriterëve dhe garancive për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Pikat 1 dhe 2 të gjetjeve të raportit të kontrollit të figurës nuk kanë të bëjnë me parashikimet e neneve 35, 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016, por me gabime në shkrim që nuk kanë pasur për qëllim fshehje të të dhënave. DSIK-ja dhe Komisioni kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi në mungesë të fakteve ose provave kanë arritur në një konkluzion të bazuar vetëm në dyshime, në kapërcim të dispozitave ligjore që lidhen me vlerësimin e figurës. DSIK-ja ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 39 të ligjit nr. 84/2016 duke kryer rishikimin e figurës, pasi ka përcjellë informacionin pa marrë të dhëna edhe nga një institucion tjetër ligjzbatuese, në kundërshtim me ligjin. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 pikat 6, 12 dhe 15 të ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një vlerësim negativ, pasi nuk ka asnjë fakt apo provë. Në raportin e DSIK-së nuk pasqyrohet asnjë e dhënë në lidhje me kontakte të papërshtatshme, si dhe nuk përcaktohet tendenca për përfshirje në veprimtari kriminale apo vënia në presion nga strukturat kriminale. Komisioni ka vepruar me dy standarde në vendimmarrjet për subjekte të tjera. Gjatë karrierës, nuk ka pasur asnjë masë disiplinore, denoncim, kallëzim apo çfarëdo informacioni tjetër për korrupsion ose lidhje të tjera, nuk është denoncuar ndonjëherë në media për veprime të kryera gjatë ushtrimit të detyrës. Në një rast, të dhënat në raportin e DSIK-së i përkasin vitit 2006, përtej periudhës së rivlerësimit. Në rastin tjetër, procedimet penale për transport klandestinësh nuk janë gjykuar prej tij. Konstatimi se dyshohet të ketë

marrë një shumë të caktuar parash për ndryshimin e masës së sigurimit për një të akuzuar për ndërtim pa leje, shkatërrim prone, mospagim taksash dhe fshehje të ardhurash, është i pabazuar në fakte. Konstatimi se ka ndikuar në favorizimin e çështjes së një shtetasi për shkak të lidhjeve familjare nuk mbështetet në prova. Konstatimi lidhur me pronat e ndodhura në {***} është arbitrar, pasi urdhri i ekzekutimit në vitin 2013 është lëshuar nga një gjyqtar tjetër (subjekti pretendon se ka dhënë vendimin e datës 04.04.2012 [kryesues i trupës gjykuese] dhe se pronat në këtë rast janë në zonën {***}). Subjekti i rivlerësimit në përfundim të trajtimit të këtyre rasteve, parashtron se informacioni është i pavërtetë dhe nuk ka lidhje me vlerësimin e figurës, por me kriterin e vlerësimit profesional.

43.2. Nga aktet e administruara në fashikuj, konstatohet se DSIK-ja, më datë 02.11.2017⁷⁹, ka dërguar raportin e kontrollit për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar plotësisht. Sipas këtij raporti të hartuar në mungesë të informacionit nga ShISH, konstatohet përshtatshmëria e subjektit. Bazuar në informacionin e përcjellë nga ShISH më datë 17.05.2018⁸⁰, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së rishikimin e raportit. Më datë 24.07.2018⁸¹, DSIK-ja ka përcjellë raportin e rishikuar, të deklasifikuar *pjesërisht*⁸², me konstatimin për papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Sipas raportit, për subjektin e rivlerësimit ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive dhe ushtrim ndikimi të paligjshëm në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Pasi dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe shqyrtoi provat e paraqitura prej tij, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë Komisionin për të kundërtën e rezultateve të raportit të DSIK-së. Sipas Komisionit, raporti i DSIK-së është i plotë dhe përmban elementet e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016.

43.3. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për shkelje të garancive për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, dhe për një qëndrim nga ana e Komisionit joobjektiv, paragjykes dhe armiqësor, është i pabazuar dhe i paprovuar prej tij me argumente dhe fakte bindëse. Ky pretendim është trajtuar gjerësisht në pjesën e pretendimeve që lidhen me procesin e rregullt ligjor, në paragrafët 12 – 26 të këtij vendimi. Siç është shtjelluar edhe më herët në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk e mbështet këtë pretendim me veprime konkrete të Komisionit apo baza mbi të cilat ai është diskriminuar. Argumenti se qëndrimi i ndryshëm i Komisionit në dy çështje të tjera në lidhje me raportet e DSIK-së, përbën standard të dyfishtë, nuk mund të përbëjë objekt analize të trupit gjykues të Kolegjit. Fakti që Komisioni, në procesin e rivlerësimit për dy subjekte të tjera nuk e ka marrë në konsideratë raportin e grupit të punës, nuk përbën argument ligjor. Të paktën dy nga këto subjekte i janë nënshtruar procesit në Kolegji⁸³ nëpërmjet ankimit nga Komisionieri Publik për kritere të vlerësimit të pasurisë. Po kështu, nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për kapërcim të dispozitave ligjore që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës dhe për kërkesën për rishikim nga ana e Komisionit, në kohën që kishte një raport të mëparshëm të DSIK-së, sipas të cilit fillimisht subjekti i rivlerësimit konsiderohej i përshtatshëm. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit institucionet e rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses te të gjitha materialet përkatëse. Grupi i punës pranë DSIK-së është brenda tagrave ligjore në kryerjen e kontrollit të figurës në procesin e rivlerësimit, siç është arsyetuar edhe në vlerësimin e

⁷⁹ Shkresa nr. {***} prot., dhe deklasifikimi me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2018, të KDZH-së.

⁸⁰ Shkresa nr. {***} prot.

⁸¹ Shkresa nr. {***} prot.

⁸² Me vendimin nr. {***}, datë 21.09.2018, të KDZH-së.

⁸³ Vendimi nr. 62, datë 03.08.2018, i përket subjektit të rivlerësimit A.M. dhe vendimi nr. 47, datë 25.07.2018, i përket subjektit të rivlerësimit A.F..

Komisionit të Venecias⁸⁴. Komisioni, pasi ka marrë të dhëna nga ShISh, të cilat mund të ndikonin në raportin e DSIK-së për kontrollin e figurës, e ka përcjellë atë me qëllim përfshirjen e këtyre të dhënave në raportin e rishikuar të DSIK-së. Kërkesa për rishikimin e raportit fillestar të DSIK-së, në rastet kur Komisioni vihet në dijeni të të dhënave që mund të ndikojnë në vlerësimin e kontrollit të figurës, është praktikë e konsoliduar prej këtij institucioni⁸⁵. Për këto arsye, pretendimi i subjektit se Komisioni është treguar paragjykses, është i pabazuar.

43.4. Nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni, më datë 06.12.2018, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, përfshirë edhe rezultatet për kriterin e kontrollit të figurës, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të raportit të grupit të punës së DSIK-së. Më datë 24.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë shpjegimet me shkrim mbi rezultatet e hetimit, përfshirë edhe shpjegimet për secilën gjetje të raportit (faqe 18 – 23), duke i bashkëlidhur rreth 38 dokumente në mbështetje të tyre. Subjekti i rivlerësimit lidhur me këto gjetje ka shprehur qëndrimin e tij edhe gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 04.01.2019, gjatë së cilës kërkoi administrimin në cilësinë e provave të reja të tri dokumente, nëpërmjet të cilave vërtetonte se nuk kishte disponuar me vendim për pronat në {***}. Në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të paraqitura prej tij, Komisioni ka konstatuar se të dhënat e raportit për dy raste nuk provohen, ndërsa për tri raste të tjera nuk është shprehur specifikisht në raport me kriterin e kontrollit të figurës.

43.5. Nga shqyrtimi i raportit të DSIK-së dhe vendimit të Komisionit, vërehet se të dyja këto institucione kanë relatuar mbi gjetjet në deklaratën e figurës, duke vënë në pah që të dhënat e deklaruara nga subjekti nuk përputheshin në të dy formularët e dorëzuar prej tij, në datat 25.10.2016 dhe 26.01.2017, konkretisht, data e aktit të miratimit për ndryshimin e mbiemrit, ashtu edhe periudha e ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në analizë të natyrës së këtyre gabimeve, konstatohet se ato janë gabime materiale që nuk ndikojnë apo pengojnë verifikimin nga DSIK-ja apo nga organet e tjera ligjzbatuese të figurës së subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, konstatohet që si DSIK-ja, ashtu edhe Komisioni nuk kanë mbajtur qëndrim në konkluzionet përfundimtare mbi pasaktësitë e konstatuara në plotësimin e formularit të kontrollit të figurës nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë element. Për pasojë, trupi gjyqësor i Kolegjit dedukton se sa më sipër nënkupton që gabimet materiale të konstatuara janë konsideruar pa peshë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të kontrollit të figurës. Për më tepër, nuk konstatohet që Komisioni t'i ketë konsideruar këto gabime si mosdeklarime, gabime me dashje për qëllime fshehjeje, apo t'i ketë klasifikuar në rastet e parashikuara nga nenet 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016 – respektivisht si deklaram i pasaktë apo i paplotë ose gjendje në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës – sikurse pretendon në ankim subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, kundërshtimi i subjektit të rivlerësimit për pasqyrimin e këtyre të dhënave, duke qenë se Komisioni nuk është shprehur për to, është i pabazuar.

43.6. Trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së dhe të pasqyruara në vendim referojnë në dyshime për veprime të paligjshme, me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në disa çështje gjyqësore. Grupi i punës së DSIK-së nuk rezulton të ketë referuar të dhëna konkrete për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të Kreut V të ligjit nr. 84/016 që rregullon kontrollin e

⁸⁴ Shih paragrafët 36 dhe 39 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në: http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php.

⁸⁵ Shih, ndër të tjera, vendimet e Komisionit nr. 41, datë 18.07.2018; nr. 92, datë 20.12.2018, nr. 93, datë 21.12.2018; nr. 124, datë 26.03.2019.

figurës. Edhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontakte, lidhje apo shkëmbime me persona të përfshirë në krimin e organizuar në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës të dorëzuar në datat 25.10.2016 dhe 26.01.2017. Raporti i DSIK-së nuk përmban informacion se subjekti rivlerësimit mund të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që formulari i kontrollit nuk është i plotë dhe i besueshëm sipas përcaktimeve të neneve 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit vëren se rastet e referuara në raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për korrupsion dhe ushtrim ndikimi të paligjshëm, në mungesë të provave apo hetimit nga ana e Komisionit, në funksion të përcaktimit të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme në dritën e nenit 38⁸⁶ të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës. Këto janë elemente që ngushtësisht lidhen me komponentë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe që më së shumti afektojnë cenimin e besimit të publikut të drejtësia.

43.7. Për sa ka rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo se ka rrethana të tilla, sipas parashikimeve të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për kriterin e kontrollit të figurës. Përfundimet e Komisionit për këtë kriter janë të paplota dhe nuk janë të mbështetura në prova të mirargumentuara dhe në përputhje me standardet e kontrollit të figurës. Subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kontrollit të figurës, janë të bazuara.

III. Mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 44.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale duke kërkuar ndryshimin e tij pasi plotëson kriterin e përcaktuar në nenet 44 dhe 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale dhe duhet të vlerësohet i aftë për të vazhduar detyrën.

44.1. Subjekti i rivlerësimit parashton se konkluzionet e Komisionit janë të kundërta me vlerësimin e KLD-së dhe janë të pabazuara në provat dhe shpjegimet e paraqitura prej tij. Vendimi, sipas tij, është i paarsyetuar [nga relatorja] dhe në kundërshtim me nenet 43, 44 dhe 57, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 6 i KEDNj-së, pasi nuk e ka pasqyruar mbrojtjen dhe nuk është shprehur për provat e paraqitura prej tij. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për vlerësimin e KLD-së, por vetëm për denoncimet anonime. Nuk ka pasur të regjistruar asnjë kërkesë për procedim disiplinor, asnjë masë disiplinore, asnjë informacion në lidhje me imunitetin ndaj çdo ndikimi apo presioni të

⁸⁶ Neni 38, pika 4: “[...] Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës [...]”.

jashtëm, apo asnjë evidentim të rasteve të konfliktit të interesit gjatë periudhës së rivlerësimit. Subjekti argumenton se ka qenë i përzgjedhur në cilësinë e moderatorit dhe është vlerësuar pozitivisht në trajnimet e zhvilluara pranë Shkollës së Magjistraturës. Shprehja e përdorur nga Komisioni “kurs i plotë i përshpejtuar” është tendencioze, për të treguar mënyrën e arsimimit dhe nuk është pasqyruar nga KLD-ja. Nuk ka mangësi profesionale dhe nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni E i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61 i ligjit nr. 84/2016 për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

44.2. Referuar raportit të KLD-së, sipas të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit për periudhën 08.10.2013 – 08.10.2016, është konstatuar se subjekti identifikon dhe zbaton normën ligjore për zgjidhjen e çështjes gjyqësore dhe ka aftësi mesatare në arsyetimin ligjor; është efektiv në përfundimin në kohë të gjykimeve; aktet themelore në administrimin e dosjeve gjyqësore janë të rregullta, të sakta dhe të plota; nuk rezultojnë të dhëna negative dhe nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, si dhe komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse dhe gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë; nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

44.3. Nga raporti i KLD-së, konstatohet se subjekti ka mangësi kryesisht në njohuritë procedurale dhe në raste sporadike ka mangësi në drejtim të arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme⁸⁷. Subjekti i ka kundërshtuar gjetjet e raportit duke paraqitur kopje të procesverbaleve të proceseve gjyqësore, urdhra të brendshëm të miratuar prej tij, kopje të vendimeve dhe të njoftimeve të palëve. Në analizën e gjetjeve nga raporti i KLD-së, por edhe në katër (4) denoncimet e verifikuara, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim nën nivelin mesatar dhe nuk është efektiv. Komisioni ka konstatuar edhe që subjekti ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit, ka mangësi të theksuara në arsyetimin ligjor, në parashtrimin e fakteve dhe përdorimin e doktrinës juridike. Nga ana tjetër, Komisioni nuk ka referuar bazën ligjore ku mbështetet vlerësimi për secilin prej konkluzioneve të parashtruara në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, të cilat gjithsesi nuk kanë qenë pjesë e dispozitave ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 në të cilat është mbështetur dhënia e vendimit.

44.4. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për vlerësimin e KLD-së, por vetëm për denoncimet anonime, nuk qëndron. Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ, përfshirë edhe vlerësimin profesional, më datë 06.12.2018. Më datë 11.12.2018, subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e tij për njohjen me aktet e administruara nga Komisioni gjatë procesit të hetimit. Më datë 24.12.2018, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat e tij në përmbushje të barrës së provës. Në rezultatet paraprake të hetimit administrativ, Komisioni (faqe 21 - 33) ka cituar të gjitha gjetjet që i kanë rezultuar nga verifikimi i kriterit të vlerësimit profesional, duke përfshirë gjetjet e KLD-së nga

⁸⁷ Referuar dosjes nr. {***}, lidhur me verifikimin e prezencës së palëve dhe detyrat e ekspertit – faqe 26 e raportit të KLD-së.

formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, gjetjet e KLD-së nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv, të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së, analizën e gjetjeve të kryera nga KLD-ja, si dhe të dhënat e denoncimeve të depozituara pranë Komisionit (7 denoncime). Për katër (4) prej tyre, Komisioni i ka kaluar në mënyrë të shprehur barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova ndaj fakteve të denoncuar.

44.4.i. Në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet e tij mbi gjetjet dhe analizën e kryera nga KLD-ja (faqe 24 – 29), duke shprehur dakordësinë e tij në përgjithësi. Për gjetjet për të cilat ka pasur kundërshtime, subjekti ka parashtruar sqarime të shoqëruara edhe me prova (rreth 38 akte), përpos shpjegimeve të dhëna për denoncimet, të cilat i ka shoqëruar me prova (rreth 99 akte). Subjekti i rivlerësimit ka shprehur qëndrimin e tij mbi gjetjet e KLD-së edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 04.01.2019⁸⁸. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit i është garantuar çdo e drejtë e parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së. Subjekti i rivlerësimit është njohur, është mbrojtur dhe është dëgjuar në lidhje me raportin e KLD-së dhe faktet e denoncimeve. Pretendimet e tij për moskonsiderim dhe mospasqyrim të provave të paraqitura për të kundërshtuar gjetjet nuk gjejnë mbështetje, pasi pavarësisht se Komisioni nuk ka cituar të gjitha provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë kriter, ato gjenden të administruara. Po ashtu, konkluzioni përfundimtar i Komisionit për këtë kriter është bazuar jo vetëm në tërësinë e analizës që ka bërë raporti i KLD-së, por edhe në analizën e dosjeve gjyqësore të sjella në vëmendje nga denoncimet e publikut, duke iu referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit për secilën situatë të denoncuar. Në këtë kontekst, Komisioni u është referuar edhe provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, dhe në disa raste duke i individualizuar ato⁸⁹.

44.4.ii. Lidhur me administrimin e provave në kontekst të garancive të nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit, përveç konstatimeve të faktit nga fashikulli, shtjelluar më sipër, sjell në vëmendje që në dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së, natyra e rregullt e procesit vlerësohet duke parë procesin në tërësinë e tij dhe veçanërisht mënyrën se si mblidhen provat (*Elsholz kundër Gjermanisë* [GC], § 66, *Devinar kundër Sllovenisë*, §45), për të verifikuar se mjetet e provës janë paraqitur në mënyrë të tillë që garantojnë një proces të rregullt (*Bliicher kundër Republikës Çeke*, § 65) dhe se gjyqtari i brendshëm duhet të bëjë një shqyrtim efektiv të provave të dhëna nga palët. “[...] Neni 6, paragrafi 1 parashikon detyrime për gjykatat që vendimet t’i arsyetojnë, por nuk mund të kuptohet si detyrim për një përgjigje të detajuar për çdo argument [...]” (*Van de Hurk kundër Holandës*, § 59)⁹⁰. Në analizë të këtyre burimeve të së drejtës, në funksion të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se mënyra e administrimit të provave nga Komisioni ka respektuar të gjitha garancitë procedurale të sanksionuara në nenin 6 të KEDNj-së.

⁸⁸ Faqe 14 e procesverbalit.

⁸⁹ Shih faqet 39-44 të vendimit të Komisionit dhe poshtëshënimin nr. 23.

⁹⁰ Shih nënparagrafin e fundit të paragrafit 319 dhe seksionin 6 “Administrimi i provave” – paragrafët 344-345: https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf dhe paragrafi 61 i arsyetimit të Gjykatës në *Van de Hurk kundër Holandës*, në: <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57878>.

45. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për vlerësimin e ndryshëm të aftësive profesionale që Komisioni ka bërë në kundërshtim me raportin e KLD-së dhe provat e administruara, trupi gjykues i Kolegjit është shprehur gjerësisht në paragrafin 21.1 më sipër. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe duket se bazohet në një interpretim alogjik, sipas të cilit procesi i rivlerësimit duhet të reduktohet në mbledhje raportesh nga institucionet ndihmëse. Për të shmangur përsëritjen, përpos sa më herët në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje detyrimet e institucioneve të rivlerësimit, sipas nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, për të kryer hetim të pavarur. Kjo dispozitë është në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit rrjedh që Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, përfshirë edhe KLD-në, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezultojnë nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit⁹¹. Po kështu, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se KLD-ja ka dhënë vlerësim pozitiv për të gjitha kriteret, nuk qëndron pasi mangësitë e konstatuara në raportin e KLD-së janë pasqyruar gjerësisht në vendimin e Komisionit⁹². Për më tepër, që raporti i KLD-së nuk përmban vlerësim të kriterëve të aftësive profesionale, por analizë ligjore të 8 dokumenteve ligjore të përpiluara prej subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 dhe në raport me kërkesat e neneve 72 – 76 të ligjit nr. 96/2016. Në konstatimin përfundimtar të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni është mbështetur jo vetëm në gjetjet e raportit të IKLD-së për pesë (5) dosjet gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, por edhe në dosjet gjyqësore të shqyrtuara si rezultat i denoncimeve nga publiku.
46. Në konstatimet përfundimtare për aftësitë profesionale, Komisioni është shprehur se subjekti i rivlerësimit ka mangësi të theksuara në arsyetimin ligjor, në parashtrimin e fakteve dhe në përdorimin e doktrinës. Ndërkohë që në një rast, është konstatuar se nuk ka disponuar për provën materiale të sekuestruar në procesin penal, mangësi që është riparuar nga Gjykata e Apelit, në një rast tjetër, arsyetimi i vendimit për zgjidhjen e martesës midis palëve ndërgjyqëse është konstatuar të jetë tepër sintetik dhe pa forcë argumentuese dhe në një rast tjetër ka treguar mangësi lidhur me verifikimin e prezencës së palëve dhe detyrat e ekspertit. Ndërsa lidhur me njohuritë ligjore është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, ndërkohë që lidhur me aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore, janë konstatuar mangësi procedurale pasi në një rast subjekti i rivlerësimit ka vendosur të thërrasë një ekspert për sqarimin e fakteve, por procedura nuk është ndjekur rigorozisht dhe detyrat nuk kanë qenë të plota, duke kërkuar ekspertim shtesë (dosja nr. 4). Ndërkohë që nga verifikimi i denoncimeve, në rastin e një denoncimi, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka reflektuar cilësi të dobëta në gjykim e arsyetim dhe se nuk ka kryer hetim të plotë mbi gjendjen, në mënyrë që të shmangë konfliktet e mëtejshme për mbivendosje pronash, duke nxitur konflikt gjyqësor.
- 46.1. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se sipas parimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i rivlerësimit të aftësive profesionale është të identifikojë magjistratët që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Referuar qëndrimit të shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, trupi gjykues i Kolegjit thekson se është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqësive të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, trajtuar edhe në opinionin CDL-AD (2016)036 të

⁹¹ Shih paragrafët 32 dhe 38 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në:

http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php

⁹² Shih faqe 31 – 39 të vendimit.

Komisionit të Venecias⁹³. Trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur edhe në jurisprudencën e deritanishme të tij⁹⁴, vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim nën nivelin mesatar dhe nuk është efektiv, nuk gjendet i argumentuar bindshëm dhe me referim konkret ligjor.

46.2. Nga ana tjetër, megjithëse Komisioni në konkluzionet përfundimtare konkludon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim nën nivelin mesatar dhe nuk është efektiv në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, në përputhje me përcaktimet e nenit E, pikat 1 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe parashikimit të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, relatori nuk rezulton të ketë propozuar vlerësimin “i papërshtatshëm” dhe Komisioni nuk ka disponuar me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Kjo zgjedhje e bën të paqartë të kuptohet nëse shkeljet/mangësitë e konstatuara nga gjetjet gjatë rivlerësimit të aftësive profesionale nuk kanë qenë në atë masë sa mund të justifikohet dhënia e kësaj mase disiplinore. Për rrjedhojë, qëndrojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë përfundim të paargumentuar bindshëm nga Komisioni.

46.3. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësime të kryera nga KLD-ja, është i pabazuar, pasi bie ndesh me ligjin nr. 84/2016 dhe me objektin dhe konceptin e rivlerësimit kalimtar. Vlerësimi i ri, sipas kriterëve të reja, në të tre komponentët përkatës, është shprehur qartë në Kushtetutë dhe në gjithë përmbajtjen e ligjit nr. 84/2016. Më konkretisht, sa u përket kriterëve të vlerësimit profesional, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 qartëson se “[...] të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve [...]”. Përpos faktit që ligji që rregullon statusin e magjistratit është miratuar më 06.10.2016, e për pasojë nuk mund përthithë vlerësimet e kryera ndër vite nga ish-KLD, edhe nga analiza e thjeshtë e kësaj dispozite si dhe Kreut II, Seksioni 1 i ligjit nr. 96/2016, del katërçipërisht qartë që me hyrjen në fuqi të këtyre dy ligjeve, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjektet i nënshtrohen një vlerësimi të ri, i cili nuk bazohet në vlerësimet e mëparshme të kryera nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë⁹⁵. Për rrjedhojë, parashtrimi i subjektit të rivlerësimit, bazuar në vlerësimet e mëparshme, nuk qëndron.

⁹³ Shih paragrafin 35 të opinionit CDL-AD (2016)036:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e) dhe 54 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

⁹⁴ Shih vendimin nr. 21, datë 13.09.2019, të Kolegjit:

<http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/11/Vendimi-G-Medja-i-anonimizuar-per-web.pdf>.

⁹⁵ Neni 77 “Burimet e vlerësimit” - Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime: a) dosja personale e magjistratit; b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji; c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91 të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara; ç) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet e hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit; d) mendimi i kryetarit; dh) të dhënat për verifikimin e aneksave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit; e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese; ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo; f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese; g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit; gj) çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të magjistratit”.

46.4. Ndërkohë që lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vlerësimi i Komisionit ka qenë tendencioz pasi ka përdorur shprehjen “kurs i përshtetshëm”, mbetet i pabazuar pasi vetëm përdorimi i një shprehjeje referuar një shkresë zyrtare⁹⁶, nuk mund të përbëjë argument për cenim të procesit të rregullt ligjor. Çfarë është më e rëndësishmja, ky pretendim është i pabazuar në kushtet kur për subjektin e rivlerësimit është kryer një hetim i plotë, janë arsyetuar nga Komisioni gjetjet dhe konkluzionet bazuar në shkresa dhe shpjegimet e tij, dhe janë garantuar të gjitha garancitë procedurale.

- 47.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit bazuar në denoncimet e publikut, duke pretenduar në mënyrë të përmblodhur se ato janë të pabazuara në ligj dhe në prova, në kundërshtim me nenet 41 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të shprehur në vendimet nr. 29/2001, nr. 75/2002, nr. 11/2003 dhe nr. 28/2016, si dhe të Gjykatës së Lartë të shprehur në vendimin nr. 4/2009. Vendimet kanë marrë formë të prerë dhe nuk mund të vlerësohen; të pambështetura në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; në kundërshtim me nenet 6 e 14 të KEDNj-së, pasi kanë shkelur privatësinë e familjes dhe kanë krijuar pasiguri; të paargumentuara se si është cenuar etika dhe figura; nuk ka konflikt të interesit apo interes pasuror në çështjet e gjykuara me palë H. Ç, të cilat pas vitit 2013, për shkak të numrit të kufizuar të organikës, janë gjykuar nga vetëm 3 gjyqtarë të gjykatës së Sarandës dhe gjyqtarë të deleguar dhe nuk ka ankesa nga palët apo institucionet për to; një pjesë e informacioneve janë jashtë periudhës së vlerësimit të aftësive profesionale dhe se Komisioni ka vepruar me dy standarde për subjekte të tjera, si në vendimin nr. 62/2018 dhe raste të tjera.

47.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të vendimit të Komisionit mbi faktet e shqyrtuara nga denoncimet, vëren se pretendimet e sipërcituara qëndrojnë pjesërisht, pasi:

a. Vendimi i referuar në denoncimin e parë, nga znj. F. K, i përket vitit 2000⁹⁷, kohë kjo që nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit 2013 – 2016 dhe as në periudhën përjashtimore të parashikuar në nenin 41, pika 4⁹⁸ e ligjit nr. 84/2016 (01.01.2006). Vendimi ka marrë formë të prerë dhe nuk ka informacione (përveç pretendimeve të denoncueses) që lidhen me etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit.

b. Vendimi i referuar në denoncimin e dytë, nga z. H. M, i përket vitit 2007⁹⁹. Ndërsa kjo periudhë shkon përtej periudhës së rivlerësimit 2013 – 2016, është brenda periudhës përjashtimore të parashikuar nga neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë për shkaqe që lidhen me aftësitë profesionale të subjektit të

⁹⁶ Bashkëlidhur vërtetimit nr. {***} prot., datë 14.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, gjendet kopja e faqes {***} të regjistrimit themeltar të punonjësve të gjykatës. Për subjektin e rivlerësimit, ndër të tjera, lidhur me arsimimin pasqyrohet shënimi “Fakulteti i Drejtësisë i U.T. (kurs i përshtetshëm)”.

⁹⁷ Me vendimin nr. {***}, datë 29.03.2000⁹⁷, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (kryetar i seancës gjyqësore - subjekti i rivlerësimit) është vendosur vërtetimi i ish-pronësisë në emër të {***} mbi numërtimin e 13 sipërfaqeve kullotë.

⁹⁸ Neni 41, pika 4 parashikon: “[4]. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”.

⁹⁹ Me vendimin nr. {***}, datë 18.10.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të vetëm) ka vendosur ndër të tjera deklarinimin fajtor të të pandehurit H. M për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim të detyrës”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i K.Penal dhe dënimin përfundimisht me 3 vite burgim. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 23.04.2008, vendosi prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim me tjetër trup gjykues (vendimi i shkallës së parë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, për shkak të shkeljes së dispozitave që lidhen me paraqitjen e akuzave të reja).

rivlerësimi (shkelje e dispozitave procedurale penale që lidhen me paraqitjen e akuzave të reja). Në kushtet kur vendimmarrja e subjektit të rivlerësimi është vlerësuar e padrejtë për shkaqe të zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykata e apelit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka vepruar drejt kur ka përfshirë faktet e këtij denoncimi në shqyrtimin në tërësi të kriterit të vlerësimi profesional të subjektit të rivlerësimi, referuar edhe parashikimit ligjor të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

c. Në denoncimin e tretë që lidhet me dyshimin e fshehjes së pasurive të subjektit të rivlerësimi në emër të krushkut, z. F. L, Komisioni ka hetuar duke kërkuar informacion për z. L mbi pasuritë e paluajtshme dhe gjendjen financiare nga bankat e nivelit të dytë. Gjatë hetimit është konstatuar edhe kontrata e huas, datë 13.02.2013, ndërmjet subjektit të rivlerësimi dhe z. F. L për dhënien hua të shumës 3500000 lekë, me afat 7 vite dhe pa interes fitimi, dorëzuar *jashtë* zyrës noteriale, sipas deklarimeve të palëve. Me deklaratën noteriale, datë 22.10.2016, F. L ka deklaruar se shumën prej 3.500.000 lekësh ia ka dhënë hua subjektit të rivlerësimi për shkak të miqësisë familjare që ka me të prej vitesh. Kontrata e huas është deklaruar nga subjekti i rivlerësimi në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013 dhe në deklaratën *vetting*.

c.i. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se bazuar në nenet 3, pika 14 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni kishte detyrimin ta konsideronte z. F. L *person tjetër të lidhur* me subjektin e rivlerësimi dhe t'i kalonte barrën e provës subjektit të rivlerësimi për të vërtetuar ligjshmërinë e burimeve financiare për dhënien hua të shumës 3.500.000 lekë. Kjo marrëdhënie interesi pasuror është pranuar nga të dyja palët. Në mungesë të cilësimit të z. L. si person tjetër i lidhur, hetimi i kryer nga Komisioni për këtë denoncim është i mangët. Në procesin e hetimit, gjendur përpara dyshimeve të ngritura nga denoncuesi për fshehje pasurie, ishte e domosdoshme që Komisioni të hetonte nëse z. L. ishte në gjendje të financonte këtë huadhënie. Nga dokumentacioni i administruar në fashikullin e hetimit administrativ në Komision, rezulton se z. L. në vitet 2007, 2009 dhe 2011 ka marrë kredi konsumatore për shuma relativisht modeste, kurse nga ana tjetër, ai paraqitet financiarisht në gjendje për të dhënë hua një shumë të konsiderueshme. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se kredia e fundit në vlerën 57900 lekë, është marrë më datë 15.02.2011 dhe është mbyllur më datë 15.02.2013 – dy (2) ditë pas dhënies së huas subjektit të rivlerësimi.

c.ii. Nga ana tjetër, vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimi gjendet në kushtet e deklaramit të rremë për shkak se deklarimet e tij përpara Komisionit janë të ndryshme nga deklaratat e datës 22.10.2016 të z. F.L., nuk është bindës dhe relevant për procesin në kushtet kur përshkrimi i bërë marrëdhënies nga secili prej tyre në thelb është i pranueshëm, pavarësisht ndryshimeve në fjalët e përdorura. Subjekti i rivlerësimi dhe z. F. L kanë qenë në marrëdhënie të ngushtë familjare (krushqi) në kohën e dhënies së huas.

c.iii. Për sa është parashtruar më sipër lidhur me këtë çështje, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni duhet t'i kishte trajtuar faktet e këtij denoncimi në kuadër të kriterit të vlerësimi të pasurisë, për vlerësimin e burimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë së paluajtshme në Tiranë nga subjekti i rivlerësimi. Megjithatë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimi gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimi të pasurisë, rezultatet e hetimit mbi burimin e huas në çdo rast nuk afektojnë rezultatin në tërësi të procesit të rivlerësimi;

d. denoncimi i katërt përmban disa elemente. Së pari, sipas denoncuesit [anonim], subjekti i rivlerësimi ka dy apartamente banimi në pallatin e z. Ç. Z dhe njëri prej tyre shërben si zyrë avokatie. Së dyti, subjekti i rivlerësimi ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit duke u shprehur me vendim në lidhje me pronat e z. H. Ç, tek i cili ka shkuar për

pushime në Kanada. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se hetimi i kryer për këtë denoncim është i plotë.

d.i. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, rezulton se shpjegimi i dhënë edhe në ankim nga subjekti i rivlerësimit se dhëndri i tij nuk ushtron aktivitet në Sarandë, bie ndesh me dokumentacionin zyrtar. Nga të dhënat e administruara nga QKB-ja, z. L është regjistruar si person fizik më datë 12.02.2014, si avokat dhe me adresë të deklaruar në qytetin e Sarandës¹⁰⁰. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se në deklarimet e tij u është referuar të dhënave të vërtetimit të Dhomës së Avokatisë Sarandë të datës 11.03.2013, që i përket një periudhe relativisht të largët (mbi 5 vite) nga data 24.12.2018, kur ai ka plotësuar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni, nuk është bindës¹⁰¹. Siç ka rezultuar edhe nga hetimi në Komision, ky apartament është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë [vetting]. Shpjegimet e subjektit lidhur me vendin e ushtrimit të profesionit nga ana e z. A. L, pavarësisht se janë të pasakta, nuk përbëjnë shkas për të konstatuar ndryshe nga sa është deklaruar nga subjekti në kriterin pasuror dhe nga sa është konkluduar nga Komisioni lidhur me këtë apartament.

d.ii. Lidhur me çështjen e konfliktit të interesit me z. H. Ç, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse H. Ç (në disa raste përfaqësuar nga e motra e tij, znj. S. I), në periudhën 2000, 2012, 2013, 2014 dhe 2015¹⁰². Për sa rezulton edhe nga aktet e administruara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendime dhe ka pranuar kërkesa në favor të z. H. Ç apo motrës së tij S. I (të paktën në 5 raste), duke filluar që me vendimin e datës 28.09.2000. Po kështu, nga komunikimet në rrjete sociale të administruara nga Komisioni, konstatohet një marrëdhënie miqësore ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. H. Ç, e vërtetuar kjo edhe me takimin e zhvilluar në Kanada. Duke u nisur nga fakti se një nga vendimet e disponuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë paditëse znj. S. I, i përket datës 03.06.2015, pra në më pak se 3 muaj përpara vizitës së subjektit në Kanada, gjatë së cilës ka pasur takim me z. H. Ç dhe ndërkohë proceset gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me palë paditëse znj. I. kanë vazhduar edhe pas kësaj date¹⁰³, dëshmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur njohje me z. Ç. dhe ka kaluar kohë me të, edhe jashtë Shqipërisë, pranuar nga ai vetë dhe nga z. Ç., pas disa vendimmarrjesh dhe gjatë procesit gjyqësor që

¹⁰⁰ Ndryshuar adresa më datë 15.05.2020.

¹⁰¹ Nga vërtetimi nr. {***} prot., datë 14.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, rezulton se për periudhën 2012 – 2018, A. L ka qenë përfaqësues në cilësinë e avokatit, në 3 procese gjyqësore (2 vendime në 2015 dhe një (1) çështje në proces gjykimi në 2018).

¹⁰² Në vendimin e datës 28.09.2000, subjekti i rivlerësimit ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të ish-pronësisë në emër të z. H. Ç në një pjesë të kullotës {***}. Me vendimin e datës 29.03.2012, subjekti i rivlerësimit (gjyqtar i vetëm) ka vendosur pranimin e kërkesës së znj. S. I, me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të AKKP-së së Zyrës Vendore Vlorë, që i njihet të drejtën e pronësisë dhe i kthen në natyrë sipërfaqen e tokës kullotë dhe pyll. Me vendimin e datës 04.04.2012, subjekti i rivlerësimit (kryesues i trupit gjykues) ka vendosur pranimin e kërkesës së paditëses S. I, të paditur AKKP (në mungesë) dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë, me objekt kundërshtimin e vendimit të ZRKKP Vlorë dhe njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin e sipërfaqes kullotë, të ndodhur në {***}. Me vendimin e datës 26.06.2012, gjyqtar i vetëm, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit H. Ç me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit H. dhe Z. Ç. Me vendimin e datës 30.04.2013, subjekti i rivlerësimit (gjyqtar i vetëm) ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkueses S. Ç me person të tretë AKKP (në mungesë), me objekt rivendosjen në afat për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit pranë AKPP Tiranë, për hapjen e dosjes për efekt të kthimit dhe kompensimit të pronës në emër të ish-pronarit J. Ç. Me vendimin e datës 25.04.2014, subjekti i rivlerësimit (kryesues i trupit gjykues) ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes me paditëse S. I, për shkak të heqjes dorë prej saj nga gjykimi i çështjes. Me vendimin e datës 03.06.2015, subjekti i rivlerësimit (kryesues i trupit gjykues) ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditëses S. I, anulimin e pjesëshëm të vendimit të AKKP-së Tiranë, njohjen e të drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve të z. H. Ç etj.

¹⁰³ Shkresat e datës 29.10.2018, të datës 30.10.2018 dhe të datës 31.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, bashkëlidhur të cilave janë përcjellë fashikujt gjyqësorë civilë, me palë ndërgjyqëse H. G. Ç. ose S. I.

lidhej me konfliktin e tij për pronat. Këto rrethana e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te drejtësia.

d.iii. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se gjyqtarët kanë përgjegjësinë që edhe në jetën jashtëgjyqësore të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Veprimet jashtëgjyqësore të gjyqtarëve duhet të jenë të atilla që të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tyre, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore dhe nuk duhet të krijojnë ose të lejojnë të tjerët të krijojnë përshtypjen se ata gjenden në një pozitë të veçantë për të ndikuar mbi të¹⁰⁴. Duke mbajtur në konsideratë se qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit, duke krijuar marrëdhënie miqësore me individë të cilët i ka pasur palë në proces, sikurse ka ndodhur me subjektin e rivlerësimit, përbëjnë sjellje që minimalisht nuk i shërbejnë besimit të publikut te drejtësia. Ky vlerësim bazohet ndër të tjera edhe në testin e “vëzhguesit të pavarur”, sipas Parimeve për Sjelljen Gjyqësore, parë në kontekstin e sjelljes së denjë. Sipas këtyre standardeve, gjyqtari duhet të shmangë kontakte të cilat mund të interpretohen se favorizojnë një palë në proces apo “ të evitojë kontakte të cilat mund të krijojnë spekulimin se gjyqtari ka një marrëdhënie të veçantë me dikë të cilin/cilën gjyqtari mund ta favorizojë në një mënyrë të caktuar¹⁰⁵. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit ka reflektuar sjellje të cilat nuk përputhen me etikën dhe sjelljen jashtëgjyqësore që një gjyqtar pritet të ketë dhe krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

48. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shkelur jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës të Lartë duke bazuar procesin e rivlerësimit të tij në çështje që janë gjykuar, është i pabazuar. Sikurse rezulton nga vendimi, Komisioni nuk ka vlerësuar themelin e çështjeve të shqyrtuara nga subjekti, por sjelljen e tij në raport me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 për kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale, kriter i cili është parashikuar nga neni E i Aneksit të Kushtetutës, Kreu VI i ligjit nr. 84/2016 – lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, etike dhe personale të magjistratëve – dhe përbën edhe pjesë të procesit të vlerësimit periodik të magjistratëve, parashikuar në Pjesën IV, nenet 68-99 të ligjit nr. 96/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se lënia ose jo në fuqi e vendimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit është argument me vlerë, por jo në vlerësimin profesional të subjekteve, pasi në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 96/2016, vlerësimi profesional analizon aftësitë profesionale të një gjyqtari nga një këndvështrim relativisht teknik, i cili nuk gjykon korrektësinë e vendimit dhe në asnjë rast themelin e çështjes, dhe asnjëherë nuk synon të zëvendësojë interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.
49. Komisioni ka konstatuar se nga vëzhgimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, vendimet e dhëna nga subjekti, në ekstraktin e publikuar në faqe rezultojnë në emër të z. A. Ç. Lidhur me këtë çështje, Komisioni ka shprehur qëndrimin se subjekti, me cilësinë e kryetarit të gjykatës, nuk ka treguar vëmendje dhe kujdes për sistemin elektronik që pasqyron aktivitetin gjyqësor të këtij institucioni, duke sjellë kështu mungesë të transparencës dhe dezinformim të publikut. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kjo çështje është trajtuar dy herë nga Komisioni, është përfshirë edhe në konstatimet dhe konkluzionet përfundimtare që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Lidhur me të, sikurse ka arsyetuar në paragrafin

¹⁰⁴ Shih parimet e Bangalores, miratuar nga Kombet e Bashkuara me rezolutën 2006/23, komentet nr. 111-114 - http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf – dhe rregullat e Kodit të Etikës, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare më 08.12.2006:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf.

¹⁰⁵ Po aty, shih komentin nr. 113, faqja 86 e Komentarit në versionin anglisht.

40, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo çështje nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi në atë masë sa për t'i atribuuar atij masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

50. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni, edhe pse është nuk është shprehur për dhënien e masës disiplinore bazuar edhe në këtë kriter, në konkluzionet përfundimtare ka çmuar që subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe mungesë efektivitetit, në një shkallë që nuk mund të zgjidhet nga trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, duke mos arritur të argumentojë bindshëm konkluzionet për nivelin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushte të konfliktit të interesit dhe në shkelje serioze të etikës së gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Mbi shkaqet e ankimit që lidhen me cenimin e besimit të publikut te drejtësia

51. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk qëndron dhe është i pavërtetë përfundimi i Komisionit se subjekti me veprimet/mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, pasi nuk ka asnjë rrethanë që kërkohet nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 për t'u përdor si shkak për shkarkimin nga detyra.

51.1. Subjekti i rivlerësimit parashtrohet se Komisioni nuk ka argumentuar provat e paraqitura duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe se ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit, ka mbajtur standarde të ndryshme në çështje të njëjta dhe se ka qenë denigruar dhe jo i drejtë pasi denoncimi i një ish-të pandehuri dhe letrat e personit anonim nuk janë elemente të mjaftueshme për të kualifikuar vlerësimin në një konkluzion të tillë. Në të kundërt, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë vlerësimet pozitive nga subjektet, si Dhoma e Avokatisë Sarandë apo qytetarët që kanë procese gjyqësore në gjykatë etj.

51.2. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, pasi Komisioni, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin të verifikojë informacione dhe të dhëna që lidhen me kriteret e vlerësimit për të garantuar një proces hetimor të plotë dhe të saktë. Përpos kësaj, qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës. Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të rrethanave, Komisioni ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

51.3. Sikurse është arsyetuar edhe në përmbajtje të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia, pasi shtëpia në fshatin {***}, e përfituar me kontratën e dhurimit nga babai, është njohur me vendim gjyqësor të dhënë gjatë kohës që ai ushtronte detyrën e Kryetarit të Gjykatës, për një sipërfaqe trualli përtej asaj që figuron në aktet e fitimit të pronësisë së kohës; ka kryer deklarime të pavërteta, të pasakta dhe kontradiktore për disa vite rresht të sipërfaqes së pasurisë që dispononte në Sarandë, duke e ndryshuar, zgjeruar dhe njohur atë përtej dokumentacionit me një vendim gjyqësor gjatë kohës që ushtronte detyrën e kryetarit të gjykatës. Përpos kësaj, marrëdhënia miqësore e tij me një nga palët ndërgjyqëse krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te drejtësia. Ky vlerësim i Komisionit, i mbështetur

edhe nga trupi gjykues i Kolegjit, nuk bazohet vetëm në informacionin e denoncimeve, por edhe në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të analizuara në raport me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit dhe në provat e administruara gjatë procesit të hetimit. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me konkluzionin se në vlerësimin tërësor, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si gjyqtar për përfitime personale në disa raste, sikurse përcakton neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

52. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankimin e tij, si dhe të gjitha provat dhe aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, çmon se:

52.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë – a) *lidhur me pasurinë “shtëpi banimi në fshatin {***}, Delvinë”*, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm mospërputhjen e sipërfaqes prej 500 m² të shtëpisë dhe truallit të përfituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 01.09.1994, dhe të regjistruar më pas me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë, datë 12.10.1995, me sipërfaqe prej 600 m²; b) *lidhur me pasurinë “shtëpi banimi në ish-objektin “{***}”, Sarandë”*, të ndërtuar para viteve 1990, me sipërfaqe objekti 48,9 m² dhe për “shtesën e katit ndërtuar mbi banesën ekzistuese”, me sipërfaqe 110 m², me burim krijimi të deklaruar në deklaratën *vetting* – leje ndërtimi, rikonstruksion banese, të regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, sipas vendimit të datës 25.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të rremë lidhur me sipërfaqen e banimit të deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*.

52.2. Për kriterin e kontrollit të figurës – Komisioni nuk ka arritur të provojë me dokumente dhe argumente bindëse se faktet e parashtruara në dokumentin e DSIK-së plotësojnë rrethanat e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, siç përcaktohet nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

52.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale – edhe pse Komisioni nuk është shprehur për dhënien e masës disiplinore bazuar edhe në këtë kriter, në konkluzionet përfundimtare ka çmuar që subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe mungesë efektiviteti në një shkallë që nuk mund të zgjidhet nga trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni nuk ka arritur të argumentojë bindshëm konkluzionet për nivelin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, por nga ana tjetër konstaton se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushte të konfliktit të interesit dhe në shkelje serioze të etikës së gjyqtarit dhe ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

53. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me konkluzionin se në vlerësimin tërësor, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si gjyqtar për përfitime personale në disa raste.
54. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit qëndrojnë dhe janë të bazuara, ato u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
55. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka shkelur etikën gjyqësore siç përcaktohet në nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me veprimet e mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 95, datë 08.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Alltun Çela.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.06.2020.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi